

Inicativë e vlerësuar me Templeton Freedom Award

INDEKSI I PERFORMANCËS SE BASHKIVE 2020

Krahasim i performancës së qeverisjes vendore me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike, rritjes së produktivitetit në ekonominë vendore dhe mundësimin e pjesëmarrjes aktive qytetare në vendimmarrje.



Indeksi i Performancës së Bashkive për Shqipërinë 2020

një iniciativë e Institutit për Politika Publike dhe Mireqeverisje e zbatuar në bashkëpunim me Institutin Lituanëz të Tregut të Lirë në sajë të mbështetjes thelbësore nga Atlas Network

Autorët

Arben Malaj
Arlind Rama
Kseniia Oleneva
Ledjon Shahini

secretary@ippm.al

www.ippm.al



PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	4
PËRFITIMET E MATJES SË PERFORMANCËS SË BASHKIVE	6
LIRIA EKONOMIKE SI AXHENDË PËR RRRITJE	7
METODOLOGJI	8
RENDITJA E PËRGJITHSHME	18
RENDITJA SIPAS KATEGORISË SË INDIKATORËVE	20
PERFORMANCA QEVERISESE SIPAS BASHKIVE	24
GJETJE DHE REKOMANDIME PERMIRESUESE	57
PYETJET E BËRA MË SHPESH	61

Parathënie

NEVOJA PËR MATJEN E PERFORMANCËS SË BASHKIVE NË SHOIPËRI

Hendeku midis institucioneve të qeverisjes vendore dhe qytetarëve në të gjitha njësitë administrative të vendit mbetet i qenësishëm dhe përbën nga një anë një nga pengesat kryesore në krijimin e sinergjisë dhe bashkëpunimit shumë të nevojshëm midis bashkive dhe qytetarëve dhe nga ana tjetër një sfidë jo të lehtë për qeverisjen vendore, shoqërinë civile por edhe për qendrat kerkimore që studiojnë dhe promovojnë mirë qeverisjen në nivel vendor.

“ Matja e performancës së bashkive dhe krahasimi i rezultateve të njësive administrative vendore në shkallë kombëtare do të krijojë një bazë të qëndrueshme informacioni gjithëpërfshirës”

Mungesa e një tradite mirëqeverisje në nivel vendor, mos njohja dhe mos aplikimi i korekt parimit të Subasidarity, mungesa e një kulture komunikimi publik, mungesa e indikatorëve matës të mirëqeverisjes vendore, shkalla e ulët e transparencës dhe vullnetit për shkëmbim informacioni dhe bashkëpunimi dhe moskëmbimi i informacionit janë pengesat kryesore që prodhojnë pasojë negative shumëdimensionale të reflektuara në cilësi të qeverisjes lokale që kërkon përmirësim, efikasitet të ulët në ofrimin e shërbimeve publike dhe mosrespektim të të drejtave të qytetarëve në lidhje me informimin e pjesëmarrjen në proceset vendimmarrëse nga institucionet vendore.

Nëse evidentojmë pasojat negative të mungesës së matjes së performancës në njësitet administra-

tive të qeverisjes vendore ato janë: (i) transparencë e ulët publike në lidhje me proceset e vendimmarrjes në nivelin lokal, e shkaktuar nga mungesa e mekanizmave efikasë që do të lejonin përfshirjen e qytetarëve; (ii) mospërfaqësim i zërit qytetar në diskursin politikëbërës në lidhje me investimet publike lokale; (iii) informacion i pa strukturuar dhe lehtësisht i kuptueshëm nga votuesit e si pasojë pa mundësi kontributi real në përmirësimin e shërbimeve publike të ofruara nga institucionet vendore;

dhe (iv) qeverisje jo efektive e fondeve publike dhe mosrealizim i investimeve të planifikuara. Ndihet nevoja e një platforme të hapur publike, interaktive që do të mundësonte një analizë krahasuese të performancës së bashkive sipas fushave të veprimtarive që do të shërbente për inkurajimin e debateve publike nën qëllimin e përmirësimit të nivelit të cilësisë së ofrimit të shërbimeve në kontekstin e mirëqeverisjes lokale në vend.

Ndertimi i një metodologjie efektive të bazuar në praktikën më të mirë ndërkombëtare dhe një set indikatorësh për fushat e rëndësishme dhe specifike të qeverisjes vendore në vend do të lehtësonte matjen e performancës së bashkive në çdo vit.

Krahasimi i rezultateve të njësive administrative të qeverisjes vendore në shkallë kombëtare në dina-

miken e tyre se pari midis tyre për të evidentuar dhe promovuar modelet dhe rastet me të sukseshme dhe se dyti analiza dinamike në vektorin kohe midis vetvetes, pra cilet prej indikatorëve është përmirësuar dhe cilet kërkojnë fokus të vecante për të përmirësuar, do të shërbente qytetarëve studiuesve dhe politikëbërësve për të përmirësuar në dinamike qeverisjen vendore si qeverisja me afërt nga e cila preken pozitivisht apo negativisht banoret e tyre.

Projektuar mbi vlerat konceptuale të Lirisë Ekonomike ky është objektivi që Instituti për Politika Publike dhe Mirëqeverisje në Shqipëri në bashkëpunim me Institutin Lituanëz të Tregut të Lirë dhe me mbështetjen strategjike të Atlas Network po synojnë të katalizojnë përmes Indeksit të Performancës së Bashkive MPI.

I pilotuar për herë të parë në Shqipëri, MPI do të sjellë në një këndvështrim krahasues perfor-

mancën e 16 bashkive në vend bazuar në një listë prej 35 indikatorësh që matin efektivitetin e qeverive vendore në krijimin e rezultateve/efekteve në funksion/shërbim të qytetarëve. Indeksi ka si objektivi strategjik inspirimin dhe ndërgjegjesimin e vete qytetarëve në politikëbërjen aktive dhe do të ndihmojë e shoqërisë civile, mediat, grupet e biznesit dhe publikun e gjerë të marrin një kuptim të gjerë gjithëpërfshirës të menaxhimit lokal të financave publike dhe dimensioned kryesore të performancës qeverisëse lokale në të gjithë kompleksitetin e saj.

Instituti për Politika Publike dhe Mirëqeverisje mbetet i dedikuar për të ridimensionuar diskursin publik mbi politikat publike duke orientuar dhe ndërtuar besueshmëri mbi politikëbërjen tek qytetarët. Ky Indeks do të jetë një kontribut i dobishëm në përmirësimin e mirëqeverisjes vendore edhe në një këndvështrim jo vetëm afatmesëm.

PËRFITIMET E MATJES SË PERFORMANCËS SË BASHKIVE

Bazuar edhe ne bashkëpunimin e dobishëm me koleget e Institutit Lituanëz të Tregut të Lirë bazuar ne dinamikën e këtij indeksi në këte vend evropian ku gradualiteti ishte një tipar specifik që eliminoi hezitimin e fillimit nga vetë bashkitë dhe ndihmoi suksesin e tij bazuar tek kredibiliteti publik i institutit, ku aktualisht vetë bashkitë i referohen indikatorëve të MPI për të përmirësuar cilësinë e qeverisjes me pjesëmarrje të qytetarëve, ne vlerësojmë se ky është një model efektiv i matjes së performancës së qeverisjes vendore në funksion të qeverisjes efektive me pjesëmarrje.

Ndihma ndaj bashkive për zhvillimin, zbatimin dhe përdorimin e indikatorëve të performancës mbetet në pararojë të misionit të IPPM për të mbështetur qeverisjen e mirë në Shqipëri. Sidoqoftë, kjo kërkon gjithashtu një angazhim të vendosur nga ana e të zgjedhurve vendore shumë të rëndësishëm për t'i hapur udhë matjes së performancës në funksion të një cilësie në përmirësim të shërbimeve publike.

Së pari, matja e performancës do të luajë një rol përcaktues në krijimin e kushteve për një qeverisje vendore me pjesëmarrje dhe do mund të ndihmojë çdo bashki të përcaktojë efektivisht prioritetet buxhetore dhe realizimin e tyre. Aktivitetet e qeverive vendore mund të përcaktohen me përparësi dhe burimet të alokohen në bazë të impaktit që ata japin për plotësimin e nevojave dhe pritjeve të qytetarëve.

Së dyti, matja e performancës ndikon drejtpërsëdrejti në kredibilitetin publik të bashkive si një element kritik për mirëqeverisje efektive. Rezulta-

tet kthehen në prioritet duke i zënë vendin qeverisjes së orientuar tek aktivitetet. Shërbimet publike të ofruara mund të optimizohen në mënyrë të vazhdueshme për t'iu përgjigjur nevojave aktuale të banorëve, deri në njesite me të vogla administrative. Një përqendrim i perkushtimit dhe efikasitetit të fondeve në nevojat konkrete të qytetarëve bën që njesitë e qeverisjes vendore të mbështeten më shumë në bashkëpunime dhe partneritete me grupet e interesit dhe komunitetin.

Së treti, matja e performancës inkurajon inovacionin. Fokusi kryesor për administratorët nuk është se si bëhet puna, por më tepër në rezultatet që arrihen nëpërmjet saj. Kjo i motivon bashkitë të menaxhojnë me efikasitet burimet dhe të motivojnë personelin për të zhvilluar ose provuar ide të reja që do të arrijnë objektivat e deklaruara.

Së katërti, përgjegjësia para qytetarëve dhe përfaqësuesve të tyre në Këshilla vjen në përmirësim sepse grupet e interesit mund të informohen rregullisht për progresin në realizimin e objektivave buxhetore vjetore. Prandaj, zyrtarët bashkiakë kanë mundësi më të madhe për të marrë vendime më të informuara mbi projekte për të cilat ka dhënë propozime përmirësuese edhe vetë komuniteti përfitues. Matja e performancës ndihmon në përmirësimin e performancës bashkiake në ofrimin e shërbimeve lokale. Ndihmon për të vendosur objektivat optimaël të performancës dhe lejon që ato objektiva të monitorohen në mënyrë efektive. MPI ndihmon në aplikimin e rregullit të artë të financave publike që me më pak para të përfitosh më shumë rezultate pozitive për komunitetin.

LIRIA EKONOMIKE SI AXHENDË PËR RITJE

Qëllimi i Indeksit të Performancës së Bashkive është të mbajë në fokus linjat kryesore të veprimtarisë së pushtetit vendor që kornizojnë lirinë ekonomike dhe formojnë një nocion të pranuar të lirisë edhe në sipërmarrje. **Së pari**, në MPI vlerësohet funksionimi i bashkive në funksion të shërbimit ndaj popullatës. Do të vlerësohet nëse ekziston një mjedis konkurrues për ofruesit e shërbimeve private (i cili nga ana tjetër siguron çmime më të ulëta për konsumatorët). Në fokus do të jenë fushat kryesore të shërbimeve publike si furnizimi me ujë, edukimi, shëndetësia dhe mirëqenia sociale ku vlerësohen kushtet që bashkitë krijojnë për mbështetjen e sektorit privat dhe nxitjen e konkurrencës. **Së dyti**, indeksi vlerëson kontributin e bashkive në krijimin e një mjedisi miqësor për investitorët dhe zhvillimin e biznesit. Bashkitë duhet të sigurojnë mjedisin më të mirë të mundshëm fiskal, për të eliminuar pengesat që parandalojnë hyrjen e bizneseve të reja në treg dhe të sigurojë të gjitha informacionet e rëndësishme për të lehtësuar këtë proces. **Së treti**, vlerësimi i indeksit do të përfshijë gjithashtu aftësinë e bashkive për të organizuar aktivitetin e tyre në shtyllat e një administrimi të duhur financiar. Ne inkurajojmë bashkitë të zbatojnë funksionet e tyre në mënyrë sa më efektive të jetë e mundur, duke përdorur sa më pak burime në dispozicion. Në këtë kategori, në fushën e Administrimit Bashkiak, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet menaxhimit efikas të aseteve dhe transparencës së aktiviteteve.

Kështu, do të rezultojnë me performancë të lartë ato bashki që:

- kursejnë paratë e taksapaguesve, operojnë duke u bazuar në të ardhurat e tyre, përdorin fondet buxhetore në mënyrë efektive dhe transparente;
- aktivitetet e tyre nuk kufizojnë zgjedhjen e kon-

sumatorit, promovojnë konkurrencën midis ofruesve të shërbimeve ose institucioneve;

- angazhohen të zvogëlojnë barrën tatimore për qytetarët dhe bizneset dhe të sigurojnë kushte të favorshme për të bërë biznes;
- menaxhojnë në mënyrë efektive asetet në posedim, siç është e nevojshme për kryerjen e funksioneve themelore të qeverisjes vendore;
- përdorin një qasje më të efektshme të kontributeve të sektorit privat në nivel vendore;
- përkushtohen të minimizojnë pengesat administrative dhe burokratike.

Në përmbledhje, Indeksi synon të matë në mënyrë indikative lirinë ekonomike në qeverisjen vendore. Aplikimi i parimeve të Lirisë ekonomike në bashki është përcaktues sepse identifikon faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë cilësinë e jetës në komunitet.

Baza krahasimore e krijuar mes bashkive ka një rëndësi parësore. Falë indeksit, bashkitë kanë mundësinë të shohin se si pozicionohen krahasimisht në një kontekst kombëtar sipas të njëjtëve indikatorë në raport me njësitë e tjera të qeverisjes vendore. Vlerat e indikatorëve pasqyrojnë aspektet në të cilat bashkia performon më mirë ose më keq në raport me bashkitë e tjera, duke nxjerrë mësim nga zgjedhjet përkatëse të bashkive me efektive që do të çonin në një liri më të madhe ekonomike e për pasojë performancë më të lartë.

Ne synojmë të kontribuojmë në krijimin e kushteve që bashkitë shqiptare të zgjedhin rrugën e lirisë ekonomike dhe shpresojmë që Indeksi i Performancës së Bashkive të ndihmojë në promovimin e zgjedhjeve pro-qytetare dhe pro-biznesit.



METODOLOGJI

METODOLOGJI

INDIKATORËIT SI PIKË REFERIMI PËR VLERAT E LIRISË EKONOMIKE

Me qëllim të rritjes së transparencës, rritjes së konkurrencës së shëndetshme midis bashkive dhe promovimit të politikave pro-rritjes dhe zhvillimit, Indeksi shërben për të përcaktuar nëpërmjet indikatorëve vlerat e lirisë ekonomike që ne i konsiderojmë thelbësore për mirëqenien e qytetarëve. Bazuar në logjikën e indikatorëve të përbërë, MPI do të shërbejë për të informuar opinionin publik mbi punën e zyrtarëve vendor të zgjedhur prej tyre. Ne besojmë se angazhimi proaktiv qytetar dhe presioni publik bëhet një arsye më shumë për bashkitë për të marrë vendime të mira dhe për të shmangur ato me impakt negativ në komunitet.

Indikatorët e përbërë ose nganjëherë edhe të emërtuar si indikatorë 'sintetikë' "formohen kur indikatorët individualë janë përpiluar në një indeks të vetëm, mbi bazën e një modeli themelor të konceptit shumëdimensional që është duke u matur" (Nardo et al., 2005, f.8); Në thelb, një indikator i përbërë mund të pasqyrojë një 'sistem kompleks' i cili përbëhet nga 'komponentë' të shumtë, duke e bërë më të lehtë për t'u kuptuar në mënyrë tërësore një fenomen sesa në mënyrë të pjesshme (Greco, Ishizaka, Tasiou, & Torrisi, 2019).

Si vlera kryesore që përcaktojnë metodologjinë tonë të vlerësimit, ne përqendrohemi në parimet e lirisë ekonomike duke vlerësuar sektorin privat dhe sipërmarrjen si promotor për rritjen e efektivitetit në vendimmarrjen publike duke optimizuar shpërndarjen e burimeve dhe duke zvogëluar barrën e taksave vendore për individët dhe familjet.

KATEGORITË E INDEKSIT, PESHAT DHE VLERËSIMI I INDIKATORËVE

Indeksi i Performancës së Bashkive përbëhet nga

katër grupe indikatorësh, kategori: "Bashkia për Qytetarët", "Bashkia për Biznesin" "Administrimi Bashkiak" dhe "Transparenca". Këto katër grupe indikatorësh përbëhen nga 11 fushat Shërbimet Komunale, Edukimi, Mirëqenia Sociale, Shërbimet e biznesit, Lejet e Ndërtimit, Shpenzimet, Të Ardhurat, Borxhi, Informacioni online, E Drejta e Informimit dhe Transparenca Buxhetore të cilat përbëhen nga 35 indikatorë. Pësha e secilës fushë varet nga numri i indikatorëve të analizuar dhe pësha e përgjithshme e grupit të indikatorëve në indeks bazohet në vlerësimin e grupit të ekspertëve.

Në pjesën e vlerësimit, shenja ↓↑" nënkupton që një vlerë më e ulët e indikatorit shoqërohet nga një vlerësim më i lartë. Shenja "↑↑" tregon që një vlerë më e lartë për indikatorin ndiqet nga një vlerësim më i lartë. Për disa indikatorë dy janë mundësitë e përgjigjes, konkretisht "Po" dhe "Jo", dhe shigjetat "↓↑" tregon se cila përgjigje jep vlerësimin e plotë. "Zgjedhja" tregon se ka disa përgjigje që përfshijnë një vlerësim cilësor të indikatorit. Indikatorët e indeksit dhe peshat e përdorura janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

VLERËSIMI I INDIKATORËVE DHE MATJA

Indikatorët maten në një sistem 100 pikësh (0 është më i ulëti dhe 100 është vlerësimi më i mirë). Vlerësimi i përgjithshëm i performancës së një bashkie është rezultati kumulativ i peshave përkatëse të 4 kategorive: Bashkia për Qytetarët, Bashkia për Biznesin, Administrimi Bashkiak dhe Transparenca. Cdo kategori ka peshën e vet bazuar në rëndësinë e kategorisë (p.sh. pësha e "Bashkia për Qytetarët" 35 pikë).

Për secilën kategori, peshat e secilit indikatorë rrjedhin nga sasia e indikatorëve (p.sh. kategoria "Administrimi Bashkiak" e përbërë nga 3 fusha in-

dikatorësh: Shpenzimet, Të ardhurat dhe Borxhi, 13 indikatorë në total, ku pesha e një indikatorë është e barabartë me 7.8%. Rezultati i performancës në secilën kategori shënohet në shkallë 100%, ku bashkia me rezultatin më të ulët merr 0% dhe maksimum 100 përqind.

Për informacion të detajuar mbi indikatorët, fushat dhe peshën e kategorive, ju lutemi referoju tabelës në pjesën vijuese.

VLERËSIMI I TË DHËNAVE QË MUNGOJNË

Kur bashkitë nuk kanë siguruar aktualisht të dhënat e nevojshme për të vlerësuar indikatorin, indikatorit do t'i caktohet vlera më e ulët e mundshme, d.m.th. vlera më e ulët i atribuohet për shkak të mungesës së të dhënave që shihet si mungesë transparence në raport me qytetarët dhe institucionet.

BURIMET E TË DHËNAVE

Indeksi u bazua në të dhënat e marra nga bashkitë, Ministria e Financave, Instituti i Statistikave, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Ministria e Edukimit, Enti Rregullator i Ujit dhe burime të tjera zyrtare të informacionit. Ne kërkuam informacion zyrtar edhe nga bashkitë nëpërmjet ushtrimit të të drejtës së informimit për qytetarët dhe nga shumica e tyre arritëm të merrnim përgjigje.

Duhet të theksohet se bashkitë dhe institucionet në varësi të tyre, në përputhje me Ligjin për të Drejtën e Informimit dhe parimet e kompletësisë, saktësisë, ligjshmërisë dhe objektivitetit, janë të detyruara të japin informacionin në disponim të tyre në përgjigje të kërkesës së qytetarëve dhe, prandaj, të dhënat e siguruar nga bashkitë nuk u vunë në dyshim me besimin në vlerësimin objektiv të aktiviteteve të tyre nga bashkitë. Informacioni i mbledhur nga bashkitë është kërkuar në bazë të formularit zyrtar dhe u është dërguar në mënyrë të njëtrajtshme njëkohësisht 16 koordinatorëve të caktuar për të drejtën e informimit të bashkive siç parashihet me ligj. Bashkitë kishin 3 javë në dispozicion të tyre, një javë më shumë se afati ligjor për të kthyer me përgjigje.

PËRZGJEDHJA E BASHKIVE

Në Indeks in e Performancës së Bashkive, bashkitë janë përzgjedhur duke marrë parasysh kriteret gjeografike në mënyrë që në fazën e pilotimit të arrihej një mbulim mbarëkombëtar. Nga secila "Qark" u zgjodh së paku një bashki dhe bashkitë vlerësohen pa bërë diferencime. Arsyeja e kësaj ishte të sfidonte opinionin publik për të kërkuar performancën më të lartë nga secila bashki pavarësisht nga madhësia ose popullsia e tyre, duke e konsideruar mirëqeverisjen një të drejtë qytetare të barabartë në cdo njësi administrative.

Indikatorët sasiorë në Indeks maten duke përdorur formulën më poshtë:

Kur vlera më e ulët e indikatorit vlerësohet më mirë (↓↑):








$$\text{Vlerësimi i Indikatorit} = \frac{\text{vlera MAX-Indikator}}{\text{(MAX-MIN)}} * 100 \text{ (pikë)}$$









Kur vlera më e lartë e indikatorit vlerësohet më mirë (↑↑)

$$\text{Vlerësimi i indikatorit} = \frac{\text{vlera e indikatorit-MIN}}{\text{(MAX-MIN)}} * 100 \text{ (pikë)}$$

MIN - vlera minimale e mundshme nga të gjitha vlerat për një indikator;

MAX - vlera maksimale e mundshme nga të gjitha vlerat për një indikator

KATEGORIA	PESHA E KATEGORISË	FUSHA E INDIKATOR-EVE	NËN-KATEGORIA E INDIKATOR-TOREVE	VLEERSIM	INDICATORI
Bashkia për Qytetarët 	35%	Shërbimet Komunale 	Ngrohja	↓↑	Cila ishte kostoja e shërbimit të ngrohjes ofruar nga bashkia?
			Norma e Taksës së pronës	↓↑	Cila ishte norma e taksës mbi pronën aplikuar nga bashkia?
			Furnizimi me ujë	↑↑	Sa ishte në gjendje bashkia që të mbulojnte kostot operative me të ardhurat e veta?
				↑↑	Sa orë në ditë UKT/bashkia furnizoi me ujë qytetarët?
				↓↑	Sa ishte cmimi I furnizimit me ujë për familjet në fundin e vitit 2019?
				↓↑	Sa ishte cmimi I furnizimit me ujë për bizneset në fundin e vitit 2019?
		Edukimi 	Edukimi	↓↑	Sa është numri i nxënësve për cdo klasë për shkollat fillore?
				↓↑	Sa është numri i nxënësve për cdo mësues për shkollat fillore?
		Mirëqënia Sociale 	Mirëqënia Sociale	↓↑	Sa është shkalla e popullsisë që përfiton nga skemat e mbrojtjes sociale për 2019?
				↓↑	Sa është përqindja e qytetarëve që përfitojnë kompensim të shpenzimeve?
			Menaxhimi i mbetjeve	↑↑	Sa është sipërfaqja e territorit të bashkisë e mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve?
↑Y/N↓	Në cilin modalitet është I organizuar shërbimi i menaxhimit të mbetjeve ? Publik apo private?				
Bashkia për Bizneset 	15%	Shërbimet per biznesit 	Shërbimet e Biznesit	↑↑	Sa ishte numri i bizneseve për 1000 banorë në fundin e 2019?
				↑Y/N↓	A ka informacion publik të disponueshëm për të orientuar bizneset në procesin e pajisjes me leje ndërtimi?
				↓↑	A ka vendime të Gjykatës Administrative që evidentojnë parregullsi nga ana e Bashkisë në raport me palet e treta?
		Lejet e Ndërtimit 	Numri I Lejeve të Ndërtimit	↑↑	Sa ishte numri i lejeve të ndërtimit lëshuar për 1000 banorë vitin e fundit?
			Pajisja me leje ndërtimi	↓↑	Sa është numri i ditëve të nevojshme për t'u pajisur me leje ndërtimi?
Administrimi Bashkiak	30%	Shpenzimet	Investimet Publike	↑↑	Sa ishte vlera e investimeve publike të realizuara për vitin nga Bashkia?
			Shpenzimet Operacionale	↓↑	Sa ishin shpenzimet e transportit të realizuara nga Bashkia në raport me totalin e shpenzimeve?
				↓↑	Sa ishte e pjesa e totalit të buxhetit dedikuar shpenzimeve të administrimit?


KATEGORIAJA	PESHA E KATEGORISË	FUSHA E INDIKATOR-EVE	NËN-KATEGORIA E INDIKATOR-TOREVE	VLEERSIM	INDICATORI
Administrimi Bashkiak 	30%	Shpenzimet 	Shpenzimet Operacionale	↑↑	Sa ishte realizimi I buxhetit aktual për vitin financiar?
				↓Y/N↑	A ka gjetur Kontrolli i Lartë i Shtetit shkelje në menaxhimin e shpenzimeve operative ne 3 vitet e fundit?
				↓↑	Sa ishte vlere mesatare e e keqmenaxhimit të fondeve të veta në 3 vitet e fundit nga Bashkia sipas Kontrollit të Lartë të Shtetit?
		Të Ardhurat 	Të Ardhurat	↓↑	A i ka realizuar Bashkia objektivat e synuara për mbledhjen e taksës së pronës?
				↓↑	Sa është numri i punonjësve të bashkisë për 1000 banorë?
				↓↑	A ishte e kushtëzuar bashkia në terma të buxhetit nga grantet e pakushtëzuara dhe transfertat?
				↑↑	Sa ishte niveli i të ardhurave të veta të bashkisë për banor?
		Borxhi 	Menaxhimi i Borxhit	↓↑	Sa ishte raporti i borxhit të bashkisë në raport me të ardhurat totale?
				↑↑	Sa ishte raporti I të ardhurave të veta ndaj totalit të të ardhurave të Bashkisë vitin e fundit?
Transparenca 	20%	Informacioni Online 	Informacioni Online	↑Y/N↓	A ka Bashkia një faqe web funksionale?
				↑Y/N↓	A ka informacion publik të disponueshëm në faqen e Bashkisë në lidhje me buxhetin vjetor?
				↑Y/N↓	Informacioni i disponueshem ne web lidhur me programet e mbështetjes dhe shërbimet publike për qytetarët?
		E drejta për Informim 	E drejta për Informim	↑Y/N↓	A është i përditësuar informacioni i disponueshëm në faqen web të Bashkisë?
				↑Y/N↓	A është i publikuar në website informacioni i kontaktit të koordinatorit për të Drejtën e Informimit?
				↑Y/N↓	A janë publike dhe të aksesueshme të dhënat e Regjistrimit të Kërkesave dhe Përgjigjeve ndaj qytetarëve?
				↑Y/N↓	A ju përgjigj Bashkia kërkesës për informacion drejtuar në kuadër të së Drejtës për Informim?
		Transparenca Buxhetore 	Transparenca Buxhetore	↑Y/N↓	A është e publikuar në faqen e Bashkisë Raporti i Monitorimit të Performancës Buxhetore?
				Prokurimet	↑Y/N↓

RENDITJA E PËRGJITHSHME

RENDITJA E PËRGJITHSHME

Në renditjen e përgjithshme të MPI, ku u matën performancat e 16 bashkive bazuar në 35 indikatorë të cilët janë të grupuara në 4 kategori: Bashkia për Qytetarët, Bashkia për Biznesin, Administrimi Bashkiak dhe Transparenca, Bashkia Shkodër renditet si bashkia me performancën më të lartë ndërsa Bashkia Sarandë ka performancën më të ulët me vetëm 28 pikë nga 100. Në 5 bashkitë me performancën më të lartë në renditje, Shkodra dhe Korca janë bashki me më shumë se 90'000 banorë, ndërsa Bulqiza, Vora dhe Patosi konsiderohen të jenë bashki të vogla në kushtet e popullsisë së tyre. Sidoqoftë, edhe bashkia me performancën më të lartë, Shkodra nuk arriti të shënonte një rezultat më të lartë se 65 pikë nga 100 që tregon se ka ende hapësirë të konsiderueshme për përmirësim të mëtejshëm të performancës së bashkisë për të ofruar vlerë në shërbimin për qytetarët. Krahasuar me rezultatin mesatar, kampioni pilot i 16 bashkive është i ndarë në gjysmë, domethënë 8 bashki kanë arritur të performojnë më mirë sesa rezultati mesatar, ndërsa 8 të tjera më pak mirë.


Në 5 bashkitë me më pak pike në renditje janë Saranda, Pogradeci, Vlora, Gjirokastrë dhe Kucova nga të cilat Vlora konsiderohet ndër bashkitë e mëdha në vend me një popullsi prej 189'311 banorësh. Rezultati i përgjithshëm i bashkisë Sarandë është 27.73 i arritur si rezultat i performancës së dobët të kësaj bashkie në katër dimensionet e analizës, rreth 14 pikë më ulët krahasuar me bashkinë me performancën e parafundit në renditje, ajo e Pogradecit.



Bashkitë nuk kanë arritur të shënojnë më shumë se 65 përqind të pikëve në kategoritë e indikatorëve Bashkia për Qytetarët dhe Bashkia për Biznesin, ndërsa ajo me performancën më të mirë në Administrimin Bashkiak ka arritur 75 përqind të pikave në dispozicion. Këto rezultate tregojnë se ekziston një nevojë urgjente që bashkitë të rishikojnë rrënjësisht performancën e tyre në drejtim të shërbimit ndaj qytetarëve dhe bizneseve. Përmirësime të mëtejshme janë gjithashtu të nevojshme për t'u ndërmarrë me fokus në menaxhimin e financave publike në nivelin bashkiak.

Indikatorët tanë janë bazuar në një qasje krahasuese të bashkive me rezultate të larta dhe atyre më pak performuese të kampionit të pilotimit prej 16, bazuar në të dhënat e mbledhura nga burimet zyrtare për secilin prej indikatorëve. Rezultatet e marra tregojnë qartë se kur bëhet fjalë për performancën e bashkive, madhësia nuk luan një rol përcaktues për sa i përket performancës së përgjithshme.

RENDITJA E PËRGJITHSHME



RENDITJA SIPAS KATEGORISË SË INDIKATORËVE

1. Bashkia për Qytetarët


Në kategorinë e Bashkisë për Qytetarët është Bashkia Shkodër që zë vendin e parë të renditjes me 62 përqind të pikëve të kategorisë së ndjekur nga bashkitë Bulqize dhe Kukës që ndajnë të njëjtin rezultat, Korca dhe Kuçova në pesë bashkitë me performancën më të mirë. Është e rëndësishme të theksohet se në grupin e Mirëqenies Sociale, bashkitë Bulqize dhe Kukës nuk shënuan nivele të larta në fushën e Menaxhimit të Mbetjeve me shërbimin që ofrohet pjesërisht nga operatorët publikë duke mos lejuar eficiencë të lartë në ofrimin e këtij shërbimi, ndërsa bashkitë e Korcës dhe Kuçovës shënuan më ulët se mesatarja në grupin e Shërbimeve komunale.

Në fushën e Shërbimeve komunale pesë bashkitë më të mira performuese janë Kukësi, Bulqize, Librazhdi, Kruja dhe Pogradeci ndërsa ato me performancën më të ulët janë Lushnja, Vora, Gjirokastra, Patosi dhe Saranda.

Në një analizë krahasimore në fushën e Edukimit, bashkitë që performojnë më mirë janë Librazhdi, Shkodra, Bulqiza, Lushnja dhe Kukësi ndërsa në fund të listës renditen Saranda, Kruja, Vlorë, Vora dhe Patosi.

Në fushën e Mirëqenies Sociale që përbëhet nga katër indikatorë, bashkitë me performancën të lartë janë Korca, Vlorë, Shkodra, Lezha dhe Kuçova. Menaxhimi i mbetjeve dhe administrimi i skemave të mbrojtjes sociale duhet të optimizohen në bashkitë me performancën më të ulët si Kukësi, Elbasani, Librazhdi, Lushnja dhe Bulqiza.

BASHKIA PËR QYTETARËT



Pesë bashkitë më pak performuese në kategorinë e Bashkisë për Qytetarët janë Saranda, Lushnja, Vora, Elbasani dhe Patosi. Këto bashki shënuan nivele të ulëta në grupin e indikatorëve të Shërbimeve komunale, duke ngritur theksin mbi nevojën për të konsideruar përmirësime të rëndësishme në këtë fushë. (Më shumë informacion mbi indikatorët për secilën fushë jepen në skedat individuale të secilës bashki në vijim)

REZULTATI I BASHKIVE SIPAS FUSHËS NE KATEGORI " BASHKIA PËR QYTETARËT"

BASHKIA	SHËRBIMET KOMUNALE	EDUKIMI	MIRËQENIA SOCIALE
Shkodër	46%	85%	80%
Bulqizë	73%	82%	36%
Kukës	91%	75%	12%
Korçë	36%	79%	87%
Kuçovë	39%	74%	78%
Pogradec	47%	74%	63%
Lezhë	39%	62%	79%
Librazhd	65%	100%	20%
Vlorë	31%	53%	83%
Krujë	50%	38%	59%
Gjirokastrë	27%	69%	65%
Patos	28%	59%	61%
Elbasan	41%	65%	17%
Vorë	27%	40%	48%
Lushnje	27%	77%	29%
Sarandë	30%	14%	41%

RENDITJA SIPAS KATEGORISË SË INDIKATORËVE

2. Bashkia për Biznesin


Në kategorinë e Bashkisë për Biznesin, pesë bashkitë me performancë më të lartë janë Patos, Kuçovë, Vorë, Lushnje dhe Korçë. Këto bashki janë përkushtuar në mënyrë të veçantë në informimin dhe lehtësimin e të bërit biznes për sipërmarrjet në zonat administrative përkatëse. Me një numër të madh ndërmarrjesh për 1000 banorë dhe me pak vendime të Gjykatës Administrative që konstatojnë parregullsi në aktivitetin e tyre ndaj sipërmarrësve, dhe procedurat mjaft efektive në pajisjen me leje ndërtimi këto bashki kanë arritur të marrin drejtimin në këtë kategori.

Bashkitë me performancën më të ulët janë Vlora, Kruja, Kukësi, Gjirokastra dhe Bulqiza, renditje e cila përcaktohet nga një performancë e ulët në ofrimin e shërbimeve për bizneset dhe vështirësitë në lëshimin e lejeve të ndërtimit nga këto qeveri lokale.

Në fushën e Shërbimeve të Biznesit renditen si pesë bashkitë kryesuese bashkitë e Lushnjes, Kuçovës, Lezhës, Patosit dhe Korcës, me bashkinë Lushnje që shënon 89 përqind nga 100, pasuar nga Kuçova dhe Lezha me 73 përqind dhe Patosi e Korca me 71 përqind. Në fund të renditjes në këtë fushë janë Vlora, Kruja, Pogradeci, Bulqiza dhe Kukësi. Rezultatet e ulëta janë rezultat i mungesës së informacionit për bizneset nga bashki në hapësirën web dhe numrit të madh të vendimeve kundër bashkive nga Gjykata Administrative në tre vitet e fundit.

Lëshimi i lejeve të ndërtimit vazhdon të mbetet një çështje madhore në kompozimin e peizazhit

BASHKIA PËR BIZNESIN



të biznesit në Shqipëri dhe kjo reflektohet ndjeshëm edhe në nivelin bashkiak. Bashkitë, ku është më e lehtë për të marrë një leje ndërtimi në Shqipëri janë Patosi, Vora, Kucova, Pogradeci dhe Bulqiza. Vështirësitë më të mëdha në krijimin e një procesi të lehtë dhe të shpejtë të marrjes së lejes së ndërtimit në Shqipëri mbeten në bashkitë e Vlorës, Kukësit, Krujës, Elbasanit dhe Gjirokastrës që janë të fundit në grupin e bashkive të zgjedhura.

REZULTATI I BASHKIVE SIPAS FUSHËS NE KATEGORI " BASHKIA PËR BIZNESIN"

BASHKIA	SHERBIMET E BIZNESIT	LEJET E NDËRTIMET
Patos	71%	54%
Kuçovë	73%	39%
Vorë	65%	50%
Lushnje	89%	8%
Korçë	71%	34%
Lezhë	73%	28%
Shkodër	69%	27%
Librazhd	68%	18%
Elbasan	65%	3%
Sarandë	36%	24%
Pogradec	25%	36%
Bulqizë	26%	34%
Gjirokastrë	43%	5%
Kukës	34%	0%
Krujë	22%	1%
Vlorë	13%	0%


RENDITJA SIPAS KATEGORISË SË INDIKATORËVE

3. Administrimi bashkiak

Administrata bashkiake është pikënisja e efektivitetit të qeverisjes lokale në shërbim të nevojave të qytetarëve që synohet të arrihet duke optimizuar alokimin e burimeve dhe duke shënuar rezultate të larta. Renditja e MPI në kategorinë e Administrimit Bashkiak për kampionin e pilotuar tregon në epërsi me performancën më të lartë në këtë drejtim bashkitë Vorë, Shkodër, Krujë, Bulqizë dhe Lushnje, të gjitha këto mbi rezultatin mesatar prej 51 përqind. Këto bashki kanë arritur të balancojnë nivelin e shpenzimeve publike në raport me performancën e mirë në realizimin e mbledhjes së të ardhurave duke mbajtur në nivele të ulëta borxhin publik lokal. Në kategorinë e Administrimit Bashkiak, bashkitë me performancë më të ulët janë ato të Patosit, Kucovës, Sarandës, Gjirokastrës dhe Lezhës.

Në fushën e të Ardhurave, bashkitë me performanca më të lartë janë Vora, Korca, Gjirokastra, Kruja dhe Saranda që manifestojnë rezultate të larta në aplikimin e niveleve të moderuara të taksave lokale, mbledhjen e kënaqshme të të ardhurave dhe mbulimin e kostove të aktivitetit me të ardhura të gjeneruara e mbledhura nga vetë bashkia. Në kahun tjetër, bashkitë me performancën më të ulët në këtë fushë indikatorësh janë Kucova, Lushnja, Kukësi, Pogradeci dhe Elbasani.

Për sa i përket Shpenzimeve, performanca optimale u arrit nga bashkitë Shkodër, Vorë, Lushnje, Elbasan dhe Kucovë ndërsa më pak efikase në realizimin e shpenzimeve janë bashkitë Sarandë, Patos, Gjirokastrë, Vlorë dhe Korçë. Në lidhje me Borxhin, pesë bashkitë me performancën më të lartë janë Shkodra, Kruja, Lushnja, Bulqiza dhe Librazhdi.



REZULTATI I BASHKIVE SIPAS FUSHËS NE KATEGORI " ADMINISTRIMI BASHKIAK"

BASHKIA	SHPENZIMET	TË ARDHURAT	BORXHI
Vorë	69%	88%	69%
Shkodër	77%	49%	100%
Krujë	43%	60%	98%
Bulqizë	50%	50%	84%
Lushnje	60%	26%	91%
Librazhd	50%	36%	84%
Vlorë	37%	49%	83%
Korçë	40%	65%	32%
Pogradec	50%	30%	81%
Kukës	51%	26%	81%
Elbasan	57%	32%	45%
Lezhë	41%	41%	67%
Gjirokastrë	29%	60%	50%
Sarandë	24%	59%	59%
Kuçovë	54%	12%	84%
Patos	28%	36%	72%

RENDITJA SIPAS KATEGORISË SË INDIKATORËVE


4. Transparenca

Transparenca mbetet një gur themeli për cilësinë e performancës bashkiake në Shqipëri dhe kjo është arsyeja pse kjo nga katër kategoritë e Indeksit të Performancës Bashkiake është ndërtuar në tre fusha, më saktësisht në informacionin e disponueshëm në faqen e internetit për qytetarët, përgjegjësinë e bashkive në kuadër të Ligji për të Drejtën e Informimit dhe transparencën e buxhetit si hapje e informacionit lidhur me zbatimin e buxhetit ndaj opinionit publik.

Bashkitë më transparente sipas indikatorëve të përzgjedhur për kampionin tonë duket se janë Shkodra, Patosi, Lezha, Korca dhe Lushnja duke shënuar dukshëm më të lart se mesatarja e rezultatit të përgjithshëm të arritur në këtë kategori. Këto bashki kush-tojnë kohë dhe përpjekje në mënyrë të vazhdueshme për të siguruar informacion të dobishëm për qytetarët dhe bizneset në lidhje me veprimtarinë e qeverisjes vendore, veprimtarinë e zbatimit të buxhetit dhe ekipet e tyre janë të shpejtë në përgjigjen e kërkesave të qytetarëve për informacionin e dërguar në adresë të koordinatorit të caktuar në kuadrin e Ligjit për të Drejtën e Informimit.

Bashkitë me performancë më të ulët në dimensionin e Transparencës janë Saranda, Kucova, Kukësi, Pogradeci dhe Gjirokastra. Këto bashki ose nuk kanë një platformë online funksionuese ose asnjë informacion i dedikuar për informimin publik nuk është i disponueshëm dhe as i arritshëm. Disa nga këto bashki nuk kanë vëmendje në transparencën e buxhetore dhe as nuk kanë thirrje të hapura për përfshirjen e qytetarëve në diskutimin politikëbërës në lidhje me prioritetet buxhetore dhe planifikimin e tyre.

TRANSPARENCA



REZULTATI I BASHKIVE SIPAS FUSHËS NE KATEGORI "TRANSPARENCA"

BASHKIA	INFORMACIONI ONLINE	E DREJTA E INFORMIMIT	TRANSPARENCA BUXHETORE
Shkodër	100%	100%	100%
Patos	100%	100%	100%
Lezhë	100%	100%	50%
Korçë	100%	100%	50%
Lushnje	100%	50%	100%
Bulqizë	67%	75%	100%
Vlorë	67%	100%	0%
Krujë	67%	75%	50%
Elbasan	100%	50%	50%
Vorë	67%	25%	100%
Librazhd	67%	50%	50%
Gjirokastër	67%	75%	0%
Pogradec	67%	50%	0%
Kukës	67%	25%	50%
Kuçovë	67%	50%	0%
Sarandë	33%	0%	0%

**PERFORMANCA
QEVERISESE
SIPAS
BASHKIVE**



BASHKIA BULQIZË



REZULTATI TOTAL 58/100

Performanca e përgjithshme

Bashkia e Bulqizës ka shënuar gjithsej 58 pikë nga 100 duke arritur në vendin e katërt në renditjen e përgjithshme të Indeksit të Performancës së Bashkive. Nga katër kategori, bashkia ka performuar më së miri në kategorinë e Transparencës me 78 përqind ndërsa kategoria ku janë hapësirat më të ndjeshme për përmirësim është Bashkia për Biznesin me 29 përqind.

Në kategorinë e Bashkisë për Qytetarët, Bashkia e Bulqizës ka shënuar 62 përqind të performancës, me respektivisht sipas fushave të indikatorëve 82 përqind në fushën e Edukimit e ndjekur nga Shërbimet Komunale 73 përqind dhe Mirëqenia Sociale me 36 përqind. Për sa i përket mbledhjes së taksës mbi pronën, bashkia mund të performojë më mirë ndërsa arrin të ketë një efikasitet të lartë për sa i përket mbulimit të kostove operative me të ardhurat e veta. Furnizimi me ujë me çmime të përballueshme për qytetarët dhe bizneset është një arritje e komunës që renditet më e larta në indikatorë. Menaxhimi i mbetjeve mbetet një fushë e performancës për përmirësim.

Në fushën e Bashkisë për Biznesin, Bashkia Bulqizë renditet në vendin e 11-të nga 16 bashki në fokus me përmirësime të rëndësishme që duhen marrë në konsideratë nga drejtuesit në lidhje me informacionin e aksesueshëm për bizneset dhe procedurat administrative që lidhen me mjedisin e të bërit biznes.

Në vendin e 4-të për kategorinë e Administrimit bashkiak, nga analiza e të dhënave duket se ka hapësirë për përmirësimin e indikatorëve që lidhen me mbledhjen e të ardhurave dhe rritjen e efikasitetit në realizimin e shpenzimeve publike. Bashkia aplikon një nivel të ulët të taksës së pronës por do të duhet të përmirësojë performancën e saj në drejtim të mbledhjes së të ardhurave duke zvogëluar kështu varësinë nga grantet e qeverisë qendrore dhe rritur investimet kapitale në zonën administrative të mbuluar nga kjo bashki.

Në kategorinë e Transparencës, Bashkia e Bulqizës renditet e 7-ta nga 16 bashki. Mbetet me rëndësi për të rritur disponueshmërinë e informacionit për qytetarët në faqen e internetit të bashkisë duke mbajtur të përditësuar atë me informacion mbi aktivitetin e bashkisë për të përmirësuar debatin publik në funksion të mirëqeverisjes vendore.

Indikatorët me performancë të lartë



Ndërmarrja UKT është efektive me çmimet më të ulëta për furnizimin me ujë të familjeve dhe bizneseve.



Aplikimi i një norme të ulët dhe të përballueshme të taksës mbi pronën krijon hapësirë për optimizimin e nevojshëm në mbledhjen dhe efikasitetin në administrimin e taksës.



Platformë online mirëfunktionale dhe reagim në kohë ndaj kërkesës së qytetarëve për informacion.

Fushat për përmirësim



Bashkia duhet të ridizajnojë dhe përmirësojë performancën e saj në mbledhjen e të ardhurave



Përmirësim i efektivitetit të programeve të mbrojtjes sociale zhvillimit socio-ekonomik për të krijuar më shumë mundësi punësimi në zonë.



Menaxhimi i mbetjeve është një fushë e kompetencave të cilës bashkia duhet t'i kushtojë më shumë vëmendje

#4

NË RENDITJEN E PËRGJITHSHME

#2



NË KATEGORINË "BASHKIA PËR QYTETARËT"

29%

REZULTAT NË KATEGORINË "BASHKIA PËR BIZNESIN"



1

Bashkia për Qytetarët





2

Bashkia për Bizneset





3

Administrimi Bashkiak



4

Transparenca





BASHKIA ELBASAN



REZULTATI TOTAL 46/100

Performanca e përgjithshme

Bashkia e Elbasanit në Indeksin e Performancës së Bashkive ka shënuar 46 pikë nga 100 duke u renditur në vendin e 14-të nga 16 bashki. Elbasani shënon ulët në kategorinë e Bashkisë për Qytetarët me 37 përqind, 40 përqind në kategorinë e Bashkisë për Biznesin, 46 përqind në Administrimin Bashkiak duke arritur performancën e saj më të lartë krahasuese në kategorinë e Transparençës me 67 përqind.

Në kategorinë Bashkia për Qytetarët, Elbasani renditet në vendin e 13-të dhe shënon 41 përqind në fushën e Shërbimeve Komunale ku furnizimi me ujë mbetet një sfidë krahas çmimit relativisht më të lartë të aplikuar për bizneset. Në fushën e Mirëqenies Sociale, Bashkia Elbasan ka një nivel të lartë të pagesave për skemat e mbrojtjes sociale që tregojnë për një efikasitet të ulët në krijimin e mundësive proaktive për punësim dhe emancipim të grupeve me të ardhura të ulëta. Asnjë e dhënë apo informacion i ndarë nga bashkia për shërbimin e Menaxhimit të mbetjeve.

Sa i përket rezultatit në kategorinë Bashkia për Biznesin, Bashkia Elbasan renditet e 9-ta duke shënuar 40 përqind. Nëse ne lidhje me dhënien e informacionit për biznesin, bashkia duket l kushton mjaft vëmendje, lëshimi i lejeve të ndërtimit është indikator i performancës më të ulët me një numër relativisht më të lartë të ditëve të nevojshme për marrjen e lejes.

Administrimi Bashkiak e sheh Elbasanin në vendin e 11 duke shënuar 46 përqind të pikëve në këtë kategori. Administrata është mjaft efi-kase në menaxhimin e burimeve buxhetore dhe realizimin e buxhetit, megjithatë të ardhurat e vetë bashkisë mbeten të ulëta dhe efektiviteti në mbledhjen e tyre gjithashtu.

Për sa i përket informacionit publik për qytetarët përmes faqes së internetit, Bashkia Elbasan shënon performancën më të lartë në raport me kategoritë e tjera, pavarësisht se përgjigja ndaj kërkesave të qytetarëve në kuadër të Ligjit për të Drejtën e Informimit merr kohë më gjatë se afatet ligjore nuk ka të dhëna në dispozicion për adresimin e ankesave qytetare.

Indikatorët me performancë të lartë



Administrata e Bashkisë Elbasan është mjaft efektive dhe në të njëjtën efektivitet edhe realizimi i buxhetit.



Informacioni publik i ofruar përmes platformës online të bashkisë është i plotë dhe raportet në lidhje me performancën buxhetore të bashkisë janë në dispozicion.



Bashkia krijon mundësi për familjet të aksesojnë furnizimin me ujë.

Fushat për përmirësim



Mbledhja e të ardhurave vendore mbetet e ulët në Bashkinë Elbasan duke kufizuar në këtë mënyrë investimet publike lokale të financuara nga fondet e veta.



Skemat e mbrojtjes sociale duhet të shoqërohen edhe nga programet aktive të aftësimi për familjet me të ardhura të ulëta duke krijuar mundësi reale për punësimin e tyre.



Bashkia duhet të synojë uljen e numrit të ditëve të nevojshme për t'u pajisur me leje ndërtimi, duke liberalizuar procedurat dhe duke krijuar mundësi për tërheqjen e investimeve.

#14

NË RENDITJEN E PËRGJITHSHME

#7



NË KATEGORINË "TRANSPARENÇA"

37%

REZULTAT NË KATEGORINË "BASHKIA PËR QYTETARËT"



1

Bashkia për Qytetarët





2

Bashkia për Bizneset





3

Administrimi Bashkiak



4

Transparenca



3

BASHKIA GJIROKASTËR



REZULTATI TOTAL 45/100

Performanca e përgjithshme

Bashkia Gjirokastrë u rendit e parafundit në renditjen e MPI, vendi i 15-të nga 16 bashki me një rezultat të përgjithshëm prej 45 pikësh. Në kategorinë Bashkia për Qytetarët shënoi një rezultat prej 47 përqind e derivuar nga fusha e Shërbimeve komunale me 27 përqind, Edukimi dhe Mirëqënia Sociale respektivisht me 69 dhe 65 përqind. Në kategorinë Bashkia për Biznes Gjirokastra shënoi 28 përqind me fushën e Shërbimeve ndaj Biznesit me 43 përqind. Në kategorinë e Transparencës rezultati i shënuar është 56 përqind.

Në kategorinë Bashkia për Qytetarë, Bashkia e Gjirokastrë renditet në vendin e 11-të me rezultat në fushën e Shërbimeve komunale prej 27 përqind, Edukimi 69 përqind dhe Mirëqënies Sociale 65 përqind. Në Shërbimet komunale rezultatet tregojnë se bashkia duhet të përmirësojë efikasitetin në furnizimin me ujë të qytetarëve duke ofruar me çmime më të përballueshme. Në indikatorët që lidhen me efektivitetin e skemave të mbrojtjes sociale, bashkia tregon një performancë të lartë ndërsa në Menaxhimin e mbetjeve ajo arrin të mbulojë një zonë të konsiderueshme me shërbime, por është ky shërbim është akoma publik.

Në kategorinë e Bashkisë për Biznes Gjirokastra renditet në vendin e 13-të me një rezultat prej 28 përqind ku vihet re mungesa e informacionit për bizneset në dispozicion të publikut dhe procedurat e zgjatura për të marrë një leje ndërtimi.

Sa i përket Administrimit bashkiak, bashkia renditet në vendin e 13-të me një performancë të ulët në fushën e Shpenzimeve ndjeshëm më e ulët se mesatarja për kategorinë. Shpenzime të larta të menaxhimit dhe investime të kufizuara publike në krahasim me bashkitë e tjera të Indeksit, si pasojë e një performancë të ulët në mbledhjen e të ardhurave. Bashkia financon aktivitetin e saj në një masë të konsiderueshme me grante të pakushtëzuara nga qeveria qendrore.

Gjithashtu në kategorinë e Transparencës, Bashkia e Gjirokastrës renditet në 5 bashkitë me performancën më të ulët ku vihet re mungesa informacionit në lidhje me zbatimin e buxhetit, performancën operationale dhe mungesa e burimeve të informacionit në dispozicion të qytetarëve dhe grupeve të interesit.

Indikatorët me performancë të lartë



Bashkia Gjirokastrë aplikon një normë të ulët të taksës mbi pronën për familjet.



Koordinim funksional në kuadër të adresimit të kërkesave të marra për Ligjin mbi të Drejtën e Informimit.



Menaxhim i efektiv i programeve të mbrojtjes sociale.

Fushat për përmirësim



Bashkia Gjirokastrë duhet të përmirësojë mbledhjen e të ardhurave të veta, në mënyrë që të krijojë hapësirë për realizimin e më shumë investimeve publike.



Përmirësimi i furnizimit me ujë për qytetarët dhe ofrimi i çmimeve më të ulëta për familjet dhe bizneset duhet të jetë prioritet.



Bashkia duhet të punojë përsëri për të krijuar një mjedis mundësues për bizneset duke ofruar informacion të dobishëm publik dhe krijuar procedura lehtësuese për to. Informacioni mbi performancën financiare mungon në faqen web.

#15

NË RENDITJEN E PËRGJITHSHME

#10



NË KATEGORINË "TRANSPARENCA"

28%

REZULTAT NË KATEGORINË "BASHKIA PËR BIZNESET"



1

Bashkia për Qytetarët





2

Bashkia për Bizneset





3

Administrimi Bashkiak



4

Transparenca



4

BASHKIA KORÇË



REZULTATI TOTAL 61/100

Performanca e përgjithshme

Bashkia e Korçës renditet e dyta nga 16 bashki në performancën e përgjithshme të bashkive në Indeks me një rezultat të përgjithshëm prej 61 pikë. Nga rezultati i arritur në katër kategori indikatorësh, performanca më e lartë rezultojnë në kategorinë e Transparencës me 89 përqind e ndjekur nga Bashkia për Qytetarët me 58 përqind, Bashkia për Biznesin me 56 përqind dhe Administrimi Bashkiak me 49 përqind.

Në kategorinë Bashkia për Qytetarët, Bashkia e Korçës renditet në vendin e 4-të me 36 përqind në fushën e Shërbimeve komunale, 70 përqind në Edukim dhe 87 përqind në Mirëqënin Sociale. Në fushën e Shërbimeve komunale duket se në lidhje me shërbimin e ngrohjes efikasiteti i furnizimit mund të përmirësohet ndërsa administrimi i pronave dhe furnizimi me ujë janë mbi performancën mesatare në Indeks. Qytetarët e kësaj bashkie përfitojnë nga furnizimi me ujë 24 orësh por çmimi i ofrimit të kësaj të mire publike është ndër më të lartit krahasuar me bashkitë e tjera.

Me një numër biznesesh të regjistruar dukshëm më të larta se mesatarja e grupit në fokus dhe informacione që lidhen me shërbimet e biznesit lehtësisht të arritshme, Bashkia e Korçës ka qenë subjekt i vendimeve të gjykatës administrative në tre vitet e fundit duke ngritur çështjen e nevojës së një maturiteti të rritur në raport me komunitetin e biznesit. Në fushën e Lejeve të Ndërtimit mund të ketë përmirësime në numrin e ditëve të nevojshme për të marrë një të tillë.

Rezultati i përgjithshëm i kategorisë së Administrimit bashkiak është 49 përqind, më i ulët se niveli i performancës mesatare në kategori, duke u renditur në vendin e 8-të në Indeks me rezultatet përkatëse sipas fushave përbërëse 40 përqind në shpenzime, 63 përqind në të ardhura dhe 32 përqind në financimin përmes borxhit. Përmirësimi i performancës mund të jetë i mundur në efikasitetin e indikatorëve në lidhje me kostot operative të administratës dhe realizimin e buxhetit. Me një shkallë relativisht të lartë të taksës mbi pronën, bashkia mund të përmirësojë performancën e saj në mbledhjen e të ardhurave dhe të zvogëlojë varësinë nga grantet.

Për Transparencën, Bashkia Korçë renditet në 5 bashkitë më të mira me rezultat të barabartë me Bashkinë Lezhë dhe Lushnjë. Një platformë mirëfunktionale e informacionit online lehtësisht e arritshme për qytetarët dhe kthimi i përgjigjeve të menjëhershme për kërkesat për informacion që i siguron bashkië rezultatet më të larta në këta dy indikatorë të lidhur. Raportet e Kontrollit të Lartë të Shtetit tregojnë për nevojën e proceseve më të hapura e transparente të prokurimit që mund të konsiderohen nga bashkia.

Indikatorët me performancë të lartë



24 orë furnizim me ujë për familjet në zonën administrative Korçë.



Një mjedis dinamik sipërmarrës i mbështetur nga mjedisi mundësues i krijuar nga Bashkia.



Një platformë informacioni e mirëfunktionale, lehtësisht e arritshme për qytetarët dhe kthimi i shpejtë i përgjigjeve në lidhje me kërkesat e marra për informacion

Fushat për përmirësim



Rritja e efikasitetit në menaxhimin e furnizimit me ujë në mënyrë që të hapet rruga për uljen e çmimeve të aplikuara për këtë të mire publike për familjet dhe bizneset.



Përqendrimi në rritjen e mbledhjes së të ardhurave të veta në mënyrë që të krijohen hapësira për rritjen e investimeve publike dhe kufizimit të rolit të granteve buxhetore apo burimeve të jashtme.



Thjeshtësimi i procedurave dhe reduktimi i numrit të ditëve të nevojshme për të marrë një leje ndërtimi.

#2

NË RENDITJEN E PËRGJITHSHME

#3



NË KATEGORINË
"TRANSPARENCA"

49%

REZULTAT NË KATEGORINË
"ADMINISTRIMI BASHKIAK"



1

Bashkia për Qytetarët





2

Bashkia për Bizneset




3

Administrimi Bashkiak



4

Transparenca





BASHKIA KRUJË



REZULTATI TOTAL 51/100

Performanca e përgjithshme

Bashkia e Krujës renditet në vendin e 8-të nga 16 bashkitë në MPI me rezultatin e përgjithshëm prej 51 pikësh (50.76) nga 100. Për sa i përket kategorive, ajo performoi më së miri në Transparencë me 67 përqind e ndjekur nga Administrimi Bashkiak me 58 përqind, Bashkia për Qytetarët me 51 përqind dhe në kategorinë e Bashkisë për Biznesin arriti një rezultat prej 14 përqind.

Në kategorinë Bashkia për Qytetarët, Bashkia e Krujës renditet në vendin e 10-të nga 16. Të dhënat mbi Shërbimet komunale tregojnë për hapësira për përmirësime të mundshme në optimizimin e menaxhimit të UKT duke vënë theks në rritjen e të ardhurave të veta të gjeneruara nga aktiviteti ndërsa është e rëndësishme për bashkinë që t'i kushtojë vëmendje të lartë përmirësimit të furnizimit me ujë për qytetarët. Shërbimi i Menaxhimit të mbetjeve ofrohet nga një operator privat që është pozitive.

Kruja shënon më ulët në kategorinë e Bashkisë për Biznesin me 14 përqind duke e renditur atë në vendin e 15-të, të para-fundit. Bazuar në metodologjinë e ndjekur kjo vjen si rezultat i informacionit të ulët on-line në dispozicion të publikut për nevojat e bizneseve dhe kohën e gjatë të pritjes për t'u pajisur një leje ndërtimi.

Kategoria e Administrimit Bashkiak e sheh Krujën të renditet si bashkia e tretë me rezultatet më të mira të shënuara me 58 përqind. Realizimi krahasimisht më i lartë i buxhetit në raport me grupin e bashkive në fokus dhe një realizim më i lartë se mesatarja i investimeve publike kanë kontribuar në këtë rezultat. Bashkia mund të punojë për të përmirësuar efikasitetin e saj në menaxhimin e administratës dhe për të reduktuar kostot operative për veprimtarinë e saj. Vlen të theksohet norma relativisht e ulët e taksës mbi pronën aplikuar nga bashkia dhe të ardhurat mbi-mesatare të mbledhura nga administrimi i pronave publike. Bashkia e Krujës nuk ka borxh, por përfiton nga grante qeveritare.

Në Transparencë, Bashkia Kruje renditet në vendin e 8-të me rezultatin 67 përqind. Më shumë informacion duhet të ofrohet hapur për qytetarët përmes faqes së internetit mbi zbatimin, monitorimin dhe performancën e buxhetit gjatë ciklit buxhetor vjetor.

Indikatorët me performancë të lartë



Bashkia Kruje mbështetet kryesisht në të ardhurat e veta për të financuar veprimtarinë e saj.



Mbi të Drejtën e Informimit, administrata e bashkisë është e shpejtë në përgjigje dhe bashkëpunuese për të shkëmbyer informacionin e kërkuar nga qytetarët.



Realizimi më i lartë i buxhetit në grupin e pergjedhur të bashkive dhe një realizim më i lartë se mesatarja e investimeve publike.

Fushat për përmirësim



Përmirësimi i furnizimit me ujë për qytetarët dhe optimizimi i efikasitetit në shpërndarjen e burimeve në funksion të furnizimit me ujë nga UKT.



Ofrimi i më shumë informacioni në internet në lidhje me zbatimin dhe monitorimin e buxhetit



Përmirësime të mundshme në rritjen e efikasitetit të administrimit dhe uljen e kostove operacionale.

8

NË RENDITJEN E PËRGJITHSHME

3



NË KATEGORINË
"ADMINISTRIMI BASHKIAK"

14%

REZULTAT NË KATEGORINË
"BASHKIA PËR BIZNESET"



1

Bashkia për Qytetarët





2

Bashkia për Bizneset




3

Administrimi Bashkiak



4

Transparenca



6

BASHKIA KUÇOVË



REZULTATI TOTAL 51/100

Performanca e pergjithshme

Bashkia e Kucovë ka shënuar një rezultat prej 51 pikë (50,74) nga 100 gjithsej duke u renditur në vendin e 10-të. Ajo shënoi 59 përqind në kategorinë e Bashkisë për Biznesin, 58 përqind në Bashkia për Qytetarët, 44 përqind në Transparencë dhe 43 përqind në Administrimin Bashkiak.

Në kategorinë Bashkia për Qytetarë, Bashkia e Kuçovës renditet në vendin e 5-të nga 16 bashki duke shënuar 78 përqind në fushën e Mirëqenies sociale, 74 përqind në Edukim dhe 39 përqind në Shërbimet komunale. Bashkia ka performuar mirë në administrimin e të ardhurave nga prona dhe menaxhuar me efikasitet UKT, megjithatë është e nevojshme të konsiderohet rritja e furnizimit me ujë për qytetarët dhe të aplikohen çmime më të ulëta duke e bërë atë më të përballueshëm për familjet dhe bizneset. Vlen të theksohet administrimi efektiv i skemave të mbrojtjes sociale nga ana e Bashkisë.

Në kategorinë Bashkia për Biznesin, Bashkia e Kuçovës u rendit e dyta me rezultatin 59 përqind. Me një numër relativisht të ulët të bizneseve për 1000 qytetarë dhe duke ofruar informacionin e plotë të nevojshëm për t'i orientuar ato, bashkia kontribuon në krijimin e një mjedisi mundësues për ndërmarrjet. Marrja e lejes së ndërtimit në Kuçovë do t'ju kërkojë më pak se numri mesatar i ditëve në krahasim me grupin e bashkive të përfshira në Indeks.

Kur bëhet fjalë për kategorinë e Administrimit Bashkiak, Bashkia e Kuçovës renditet në pozicionin e 15-të duke nxjerrë në pah disa çështje në nevojë për t'u adresuar. Me shpenzime të ulëta kapitale për frymë dhe taksën më të lartë mbi pronën të aplikuar në krahasim me bashkitë e tjera, bashkia ka vështirësi në mbledhjen e të ardhurave dhe varet shumë nga grantet e qeverisë qendrore.

Në kategorinë e Transparencës, faqja e internetit e bashkisë nuk përditësohet me informacionin më të fundit dhe qytetarët duket se e kanë të vështirë të gjejnë dhe të marrin informacion në lidhje me buxhetin dhe performancën financiare të institucionit. Këshilli i Lartë i Shtetit sipas raporteve zyrtare ka gjetur gjithashtu parregullsi në administrim në vitet e fundit.

Indikatorët me performancë të lartë



Bashkia e Kucovës ka performuar mirë në administrimin e të ardhurave nga ndërtesat dhe menaxhuar me eficiencë UKT.



Administrim efektiv i skemës së mbrojtjes sociale duke optimizuar shpërndarjen e burimeve për qytetarët në nevojë.



Më pak se numri mesatar i ditëve të nevojshme për të marrë një leje ndërtimi ndërkohë që bashkia ofron informacion të plotë për bizneset online.

Fushat për përmirësim



Bashkia duhet t'i kushtojë vëmendje rritjes së furnizimit me ujë për qytetarët dhe ofrimit me çmime më të ulëta për familjet dhe bizneset.



Përmirësime të mundshme në rritjen e efikasitetit në administrimin e bashkisë dhe uljen e kostove operacionale



Bashkia duket se ka vështirësi në mbledhjen e të ardhurave dhe nuk bën publike për qytetarët dokumentacionin mbi transparencën buxhetore.

#10

NË RENDITJEN E PËRGJITHSHME

#2



NË KATEGORINË "BASHKIA PËR BIZNESET"

43%

REZULTAT NË KATEGORINË "ADMINISTRIMI BASHKIAK"



1

Bashkia për Qytetarët





2

Bashkia për Bizneset





3

Administrimi Bashkiak



4

Transparenca





BASHKIA KUKËS



REZULTATI TOTAL 47/100

Performanca e përgjithshme

Bashkia e Kukësit renditet e 11-ta në Indeksin e Performancës së Bashkive, duke shënuar gjithsej 47 pikë (47.45) nga 100. Më konkretisht, 62 përqind në kategorinë e Bashkisë për Qytetarët, 46 përqind në Administrimin Bashkiak, 44 përqind në Transparencë dhe 21 përqind në kategoria e Bashkisë për Biznesin.

Në kategorinë Bashkia për Qytetarët Bashkia e Kukësit renditet e treta nga 16 bashki duke shënuar 91 përqind në fushën e Shërbimeve komunale, 75 përqind në Edukim dhe 12 përqind në Mirëqenien sociale. Performanca më e lartë në krahasim me bashkitë e tjera shënohet në indikatorin e mbledhjes së të ardhurave nga administrimi i ndërtesave dhe menaxhimin me efikasitet të shërbimit të ngrohjes ndërsa mbulon 100 përqind kostot në administrimin e UKT me të ardhurat e veta. Bashkia ofron 24 orë furnizim me ujë për familjet dhe bizneset me çmime të përballueshme. Efektiviteti më i lartë në menaxhimin e skemave të mbrojtjes sociale do të kontribuonte në fuqizimin e qytetarëve në nevojë për të kapërcyer kurthin e varfërisë.

Renditur në vendin e 14-të në kategorinë Bashkia për Biznesin duke shënuar 21 përqind, Bashkia e Kukësit duhet t'i kushtojë vëmendje krijimit të një mjedisi mundësues për bizneset duke u siguruar atyre informacionin e nevojshëm lehtësisht të aksesueshëm dhe krijimin e kushteve për të zvogëluar numrin e ditëve të nevojshme për të marrë një leje ndërtimi.

Për Administrimin Bashkiak, Bashkia Kukës shënon një nivel të ulët të investimeve publike për frymë dhe krahasimisht nivelin më të ulët të të ardhurave të veta në krahasim me shpenzimet totale, ndërsa mbetet pothuajse plotësisht e varur nga grantet që vijnë nga qeveria qendrore.

Faqja web e bashkië duhet të jetë e përditësuar dhe të sigurojë një informacion lehtësisht të arritshëm për qytetarët që janë të interesuar për të qenë pjesë e debatit publik për cilësinë e mirëqeverisjes. Asnjë informacion në lidhje me koordinatoren e caktuar për të Drejtën e Informimit nuk gjendet publikisht dhe as përgjigje ndaj kërkesës së bërë nuk është marrë.

Indikatorët me performancë të lartë



Menaxhim efikas i shërbimeve bashkiake dhe UKT që mbulon 100 për 100 shpenzimet operative me të ardhurat e veta.



24 orë furnizim me ujë për familjet dhe bizneset me çmime të përballueshme



Niveli i lartë i realizimit të buxhetit.

Fushat për përmirësim



I nevojshëm efektivitet më i lartë në menaxhimin e skemave të mbrojtjes sociale.



Me rëndësi ulja e numrit të ditëve të nevojshme për të marrë një leje ndërtimi.



Përditësimi i platformës së hapur web me informacionin e bashkië për qytetarët dhe bizneset.

#11

NË RENDITJEN E PËRGJITHSHME

#3



NË KATEGORINË "BASHKIA PËR QYTETARËT"

44%

REZULTAT NË KATEGORINË "TRANSPARENCA"



1

Bashkia për Qytetarët





2

Bashkia për Bizneset





3

Administrimi Bashkiak



4

Transparenca





BASHKIA LEZHË



REZULTATI TOTAL 59/100

Performanca e përgjithshme

Bashkia e Lezhës renditet e treta në renditjen e përgjithshme të Indeksit të Performancës së Bashkive për këtë vit me një rezultat të përgjithshëm 59 nga 100 pikë. Performanca e saj më e lartë u shënuar në kategorinë e Transparencës me rezultatin 89 përqind, ndjekur më pas nga kategoritë e Bashkisë për Qytetarët dhe Bashkia për Biznesin përkatësisht me 56 dhe 55 përqind dhe Administrimin Bashkiak me 45 përqind.

Në kategorinë Bashkia për Qytetarët, Bashkia e Lezhës renditet në vendin e 7-të duke shënuar 56 përqind në total me 39 përqind në Shërbimet komunale, 62 përqind në fushën e Edukimit dhe 79 përqind në fushën e indikatorëve që lidhen me Mirëqenien sociale. Efikasë në menaxhimin e shpenzimeve të lidhura me shërbimin e ngrohjes dhe furnizimin me ujë të pijshëm, referuar indikatorëve duket se mund të bëhen përmirësime në uljen e çmimeve të aplikuar nga UKT në lidhje me furnizimin me ujë të familjeve dhe bizneseve. Përsa i përket shërbimit të Menaxhimit të mbetjeve, bashkia mbulon të gjitha zonat administrative dhe shërbimi ofrohet nga operatorët privatë që lejojnë performancë më të lartë

Performanca në kategorinë Bashkia për Biznesin e rendit Lezhën në vendin e 6-të me një rezultat për kategorinë prej 55 përqind. Bizneset e kanë të lehtë të gjejnë të gjithë informacionin e nevojshëm në platformën informative online e dedikuar për komunitetin e biznesit ndërkohë që numri i ditëve të nevojshme për t'u pajisur me leje ndërtimi është më i ulëti në raport me bashkitë e tjera në Indeks.

Në kategoritë e Administrimit bashkiak, Bashkia Lezhë renditet në vendin e 12-të me rezultatin e arritur prej 45 përqind. Me rezultatin përkatës prej 41 përqind në fushën e treguesve të të ardhurave dhe shpenzimeve, bashkia ka një borxh të ulët. Me shpenzimet kapitale relativisht më të ulëta të për frymë, e me të ardhura të veta të mbledhura në rritje, grantet nga qeveria qendrore vijnë të zënë rreth gjysmën e buxhetit vjetor të bashkisë.

Në kategorinë e Transparencës, Bashkia Lezhë renditet në vendin e 4-të me një rezultat të barabartë me vendin e 3-të dhe të 5-të nga 16. Një platformë web mirëfunktionale dhe përgjigja e shpejtë e kërkesave të qytetarëve për informata e bëjnë këtë bashki një nga ato me performancën më të mirë.

Indikatorët me performancë të lartë



Shërbimi i Menaxhimit të mbetjeve mbulon të gjitha zonat administrative dhe sigurohet nga operatorët privatë që lejojnë performanca më të larta.



Informacion lehtësisht i aksesueshëm për shërbimet e biznesit dhe koha e ulët e pritjes për t'u pajisur me një leje ndërtimi.



Një faqe web mirëfunktionale dhe përgjigje e shpejtë nga administrata ndaj kërkesave të qytetarëve për informacion.

Fushat për përmirësim



Mund të bëhen përmirësime në uljen e çmimeve për furnizimin me ujë për familjet dhe bizneset.



Nivel i ulët i investimeve publike për frymë dhe varësia nga grantet mbetet çështje për adresim.



Rritja e efektivitetit të taksave dhe mbledhjes së të ardhurave të veta është i rëndësishëm për të krijuar hapësira për më shumë programe të zhvillimit socio-ekonomik në mbështetje të grupeve të marginalizuara.

#3

NË RENDITJEN E PËRGJITHSHME

#4



NË KATEGORINË "TRANSPARENCA"

45%

REZULTAT NË KATEGORINË "ADMINISTRIMI BASHKIAK"



1

Bashkia për Qytetarët





2

Bashkia për Bizneset




3

Administrimi Bashkiak



4

Transparenca





BASHKIA LIBRAZHID



REZULTATI TOTAL **53/100**

Performanca e përgjithshme

Bashkia e Librazhdit ka shënuar një rezultat prej 53 pikë nga 100 duke u renditur në vendin e 7-të nga 16 bashki në Indeksin e Performancës së Bashkive. Ajo shënoi 56 përqind në kategoritë e Bashkisë për Qytetarët dhe Transparencës, 50 përqind në Administrimin Bashkiak dhe 48 përqind në Bashkia për Biznesin.

Në kategorinë Bashkia për Qytetarët, Bashkia e Librazhdit shënoi 56 përqind duke u renditur e 8-ta në këtë kategori duke lënë pas 8 bashki të tjera që performuan më poshtë. Me rezultatin maksimal në Edukim, 65 përqind në Shërbimet komunale dhe vetëm 20 përqind në fushën e Mirëqenies Sociale. Në fushën e Shërbimeve komunale bashkia është efi-kase në menaxhimin e shërbimit të ngrohjes dhe arrin të furnizojë me 24 orë familjet dhe bizneset, megjithatë çmimi i ofrimit mund të jetë më i ulët. Në fushën e Edukimit, bashkia ka krijuar kushte për të pasur një numër optimal të nxënësve për klasë dhe rrjedhimisht nxënës për mësues. Mbetet me rëndësi që bashkia të përmirësojë efektivitetin e skemave të mbrojtjes sociale.

Në marrëdhëniet me biznesin, Bashkia e Librazhdit shënon 48 përqind në fushën e Bashkisë për Biznesin duke u renditur në vendin e 8-të. Me një numër të ulët biznesesh për frymë, bashkia kujdeset që bizneset të kenë akses të lehtë dhe falas në informacionet e nevojshme lidhur me të bërit biznes në zonë dhe ka përmirësuar cilësinë e vendimmarrjes që vihet re nga numri në rënie i vendimeve në disfavor nga Gjykatën Administrative. Sa i përket indikatorit të lidhur me Lejet e Ndërtimit, bashkia duhet të zvogëlojë numrin e ditëve të nevojshme për t'u pajisur me leje.

Rezultatet e kategorisë së Administrimit Bashkiak e renditin Bashkinë Librazhd në vendin e 6-të me një rezultat prej 50 përqind. Me investime publike relativisht më të larta për frymë dhe një efikasitet të lartë në administrimin e burimeve, bashki duhet të përmirësojë ndjeshëm performancën e saj në mbledhjen e të ardhurave. Është e nevojshme që të zvogëlohet niveli i granteve të qeverisë qendrore dhe rritja e efektivitetit në mbledhjen e të ardhurave të veta për të mbështetur zhvillimin socio-ekonomik në bashki.

Për Transparencën, Bashki e Librazhdit ka shënuar 56 përqind duke u renditur në vendin e 10-të midis 16 bashkive. Me një faqe web funksionale mbetet e rëndësishme që të bëhet rregullisht përditësimi i informacionit në dispozicion të publikut, si dhe t'i jepet rëndësi përgjigjes së kërkesave të ardhura nga qytetarët në kuadër të Ligjit për të Drejtën e Informimit.

Indikatorët me performancë të lartë



Investimet më të larta publike për frymë dhe një efikasitet i lartë në administrimin e burimeve



Bashkia ka krijuar kushte për të patur një numër optimal të nxënësve për klasë



Bizneset kanë akses të lehtë dhe falas në informacionin e nevojshëm mbi të bërit biznes në zonë dhe një numër në rënie i çështjeve në Gjykatën Administrative.

Fushat për përmirësim



Me rëndësi ulja e ditëve të nevojshme për të marrë një leje ndërtimi.



Bashkia duhet të përmirësojë ndjeshëm performancën në mbledhjen e të ardhurave për të qënë më pak e pavarur nga grantet.



Me rëndësi përditësimi i informacionit publik në dispozicion për qytetarët dhe përgjigja ndaj kërkesave të tyre për informacion.

#7

NË RENDITJEN E PËRGJITHSHME

#6



NË KATEGORINË "ADMINISTRIMI
BASHKIAK"

56%

REZULTAT NË KATEGORINË
"TRANSPARENCA"



1

Bashkia për Qytetarët





2

Bashkia për Bizneset





3

Administrimi Bashkiak



4

Transparenca





BASHKIA LUSHNJE



REZULTATI TOTAL 52/100

Performanca e pergjithshme

Bashkia Lushnje renditet në vendin e 8-të në Indeksin e Performancës së Bashkive duke shënuar gjithsej 52 pikë. Sipas kategorive, bashkia shënoi përkatësisht 78 përqind në Transparencë, 56 përqind në Bashkia për Biznesin, 52 përqind në Administrimin Bashkiak dhe 36 përqind në Bashkia për Qytetarët.

Në kategorinë Bashkia për Qytetarët, Bashkia Lushnje shënoi 36 përqind duke u renditur në vendin e 15-të me një performancë krahasimisht të ulët. Thelbësore për bashkinë është rritja e numrit të orëve të furnizimit me ujë në zonat administrative nën administrimin e tij, çmime më të ulëta të aplikuara për familjet dhe bizneset dhe përmirësimi i eficiencës. Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve gjithashtu duhet të përmirësohet nga ana e bashkisë.

Bashkia Lushnje ka krahasimisht numrin më të madh të bizneseve për 1000 banorë dhe renditet në vendin e 4-të në kategorinë Bashkia për Biznesin. Pavarësisht se u përgjigjet nevojave të bizneseve për informacion, numri i ditëve të nevojshme për t'u pajisur me një leje ndërtimi mbetet një nga më të lartat në grupin e 16 bashkive në focus duke e bërë të domosdoshme ndërmarrjen e hapave në këtë drejtim.

Për Administrimin Bashkiak, Bashkia Lushnje shënoi 52 përqind duke u renditur në vendin e 5-të nga 16 bashki. Me një nivel të ulët të investimeve publike për frymë dhe një realizim të lartë të buxhetit, bashkia duhet të përmirësojë eficiencën e saj në administrim dhe të rrisë nivelin e mbledhjes së të ardhurave të veta që vijnë nga tatimi mbi pronën dhe taksat e tjera lokale nën autoritetin e bashkisë.

Bashkia shënon 78 përqind në kategorinë e Transparencës duke u renditur në vendin e 3 pas bashkive Shkoder dhe Patos. Pavarësisht se ka një faqe web mirëfunktionale dhe të thjeshtë për përdoruesit, e cila ofron të gjitha informacionet e nevojshme që qytetarët të ndjekin aktivitetet dhe performancën e bashkisë, vlen të përmendet që bashkia nuk iu përgjigj kërkesës për informacion në kuadër të Ligjit për të Drejtën e Informimit. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka publikuar ne raportet e 3 viteve të fundit gjetje në vlera të kufizuara në lidhje me procedurat e prokurimit publik nga bashkia.

Indikatorët me performancë të lartë



Funksionimi i plotë i platformës web duke siguruar të gjithë informacionin e nevojshëm që qytetarët të ndjekin aktivitetet dhe performancën e bashkisë



Numri më i madh i bizneseve për 1000 banorë.



Informacion i plotë dhe mbështetje për kërkesat e bizneseve për procedurat e ndjekura nga bashkia.

Fushat për përmirësim



Rritja e orëve të furnizimit me ujë në zonat administrative nën administrimin e bashkisë, çmime më të ulëta të aplikuara për familjet dhe bizneset.



Rritje e efektivitetit në mbledhjen e të ardhurave dhe përmirësimi i shërbimit të Menaxhimit të Mbetjeve.



Ulje e numrit të ditëve të nevojshme për të marrë një leje ndërtimi.

#8

NË RENDITJEN E PËRGJITHSHME

#5



NË KATEGORINË "ADMINISTRIMI BASHKIAK"

36%

REZULTAT NË KATEGORINË "BASHKIA PËR QYTETARËT"



1

Bashkia për Qytetarët





2

Bashkia për Bizneset




3

Administrimi Bashkiak



4

Transparenca





BASHKIA PATOS



REZULTATI TOTAL 57/100

Performanca e përgjithshme

Bashkia e Patosit renditet në vendin e 5-të nga 16 bashki me një rezultat të përgjithshëm prej 57 pikësh. Bashkia shënoi 100 përqind në Transparencë, 64 përqind në Bashkia për Biznesin, 44 përqind në Bashkia për Qytetarët dhe 38 përqind në Administrimin Bashkiak.

Në kategorinë Bashkia për Qytetarët, Bashkia e Patosit renditet në vendin e 12-të me rezultatin 44 përqind. Sipas fushave të indikatorëve përkatës, performanca e bashkisë është vlerësuar në Shërbimet Komunale me 28 përqind, Edukimi 59 përqind dhe Mirëqenia Sociale me 61 përqind. Bashkia duhet të përqendrojë përpjekjet e saj për përmirësimin e performancës për rritjen thelbësore të furnizimit me ujë për qytetarët duke kërkuar një eficiencë më të lartë në menaxhimin e UKT. Skemat e mbrojtjes sociale duket se kanë një menaxhim efektiv ndërsa shërbimi i Menaxhimit të Mbetjeve mbetet publik.

Me performancën më të lartë në kategorinë Bashkia për Biznesin, Bashkia e Patosit renditet në vendin e parë me një rezultat 64 përqind, dhe me pikë sipas fushave përkatësisht 71 përqind në Shërbimet e Biznesit dhe 54 përqind në pajisjen me Leje Ndërtimi. Megjithë numrin më të ulët të ditëve në pajisjen me leje ndërtimit, bashkia duket se nuk është në gjendje të krijojë interes mjaftueshëm tek zhvilluesit për të investuar në zonë. Megjithë numrin e vogël të bizneseve për banor, bashkia në mënyrë aktive luan rolin e saj në sigurimin e informacionit të nevojshëm për shërbimet që lidhen me qeverisjen vendore.

Në Administrimin Bashkiak, Bashkia e Patosit renditet e fundit me performancë konsiderueshëm të ulët në krahasim me bashkitë e tjera në analizë në lidhje në mbledhjen dhe menaxhimin e të ardhurave. Me një nivel të lartë të kostove të administratës dhe varësi nga grantet e qeverisë qendrore, Bashkia e Patosit do të duhet të rikonceptojë modelin e menaxhimit të operacioneve me qëllim optimizimin në gjenerimin dhe shpërndarjen e burimeve.

Në kategorinë e Transparencës, Bashkia Patos renditet e dyta duke ndarë të njëjtin numër pikësh me Bashkinë Shkodër. Bashkia arriti rezultatin më të lartë në tre fushat e kësaj kategorie përkatësisht Informacioni në internet, E Drejta e Informimit dhe Transparenca Buxhetore.

Indikatorët me performancën të lartë



Menaxhim efektiv i skemave të mbrojtjes sociale.



Numri më i ulët i ditëve të nevojshme në pajisjen me leje së ndërtimi.



100 përqind në transparencën buxhetore.

Areas for improvement



Rritja e furnizimit me ujë për qytetarët dhe një efikasiteti më i lartë në menaxhimin e UKT.



Përmirësim i performancës në mbledhjen dhe menaxhimin e të ardhurave



Rikonceptim i modelit të menaxhimit për të optimizuar gjenerimin dhe shpërndarjen e burimeve

#5

NË RENDITJEN E PËRGJITHSHME

#1



NË KATEGORINË "BASHKIA PËR BIZNESET"

38%

REZULTAT NË KATEGORINË 'ADMINISTRIMI BASHKIAK'



1

Bashkia për Qytetarët





2

Bashkia për Bizneset





3

Administrimi Bashkiak



4

Transparenca



12

BASHKIA POGRADEC



REZULTATI TOTAL 47/100

Performanca e përgjithshme

Bashkia e Pogradecit renditet e 12-ta në renditjen e përgjithshme të MPI me një rezultat prej 47 nga 100. Për sa i përket kategorive, rezultatet përkatëse janë 57 përqind në Bashkia për Qytetarët, 47 përqind në Administrimin Bashkiak, 44 përqind në Transparencë dhe 30 përqind në Bashkia për biznesin.

Në kategorinë Bashkia për Qytetarët, Bashkia e Pogradecit renditet në vendin e 6-të me rezultatin 57 përqind ndërsa shënoi 47 përqind në Shërbimet Komunale, 74 përqind në Edukim dhe 63 përqind në Mirëqenien Sociale. Të ardhura të ulëta nga administrimi i pronave dhe jo një UKT me performancë të lartë, bashkia arrin të sigurojë vëllim relativisht të lartë të furnizimit me ujë për qytetarët e saj. Me një raport optimal të nxënësve për klasë, bashkia i ka besuar shërbimin e menaxhimit të mbetjeve një ofruesi privat që mbulon 100 përqind të territorit.

Kategoria Bashkia për Biznesin provon disa pika të dobëta të performancës së Bashkisë së Pogradecit në lidhje me mbështetjen e dobët për bizneset dhe numrin e ulët të bizneseve të regjistruara. Të qenit një bashki turistike me një potencial të pashfrytëzuar, një partneritet pro-rritjes i bashkisë me bizneset duket se është një domosdoshmëri për të çuar përpara zhvillimin socio-ekonomik në zonë. Vendimet e Gjykatës Administrative në disfavor të bashkisë për vitin 2019 kanë shënuar një rritje në krahasim me një vit më parë, gati dyfishuar.

Në kategorinë e Administrimit Bashkiak, me rezultat 47 përqind, Bashkia e Pogradecit u rendit në vendin e 9-të me rezultatet sipas fushave të indikatorëve përkatësish Shpenzimet 50 përqind, Të ardhurat 30 përqind dhe financimi me Borxh me rezultatin 81 përqind. Bashki duhet të kushtojë vëmendje në rritjen e efektivitetit në mbledhjen e të ardhurave dhe zvogëlimin e varësisë nga grantet e qeverisë qendrore, duke optimizuar menaxhimin e operacioneve.

Në kategorinë e Transparencës, Bashkia e Pogradecit shënoi 44 përqind duke u renditur në vendin e 14-të me përmirësime të mundshme në përditësimin e vazhdueshëm të platformës web për të informuar qytetarët mbi proceset e vendimmarrjes së qeverisjes vendore dhe përfshirjen e tyre në mënyrë aktive në këtë proces.

Indikatorët me performancë të lartë



Organizimi optimal i skemës së mbrojtjes sociale duke u përqëndruar tek individët në nevojë.



Shërbim efektiv i menaxhimit të mbetjeve i operuar nga një kompani private.



Furnizimi i bollshëm me ujë të pijshëm për qytetarët me çmime të përballueshme.

Fushat për përmirësim



Mbështetje e dobët për bizneset dhe numër i vogël i bizneseve të regjistruara.



Rritja e numrit të vendimeve të Gjykatës Administrative kundër procedurave të ndjekura nga bashkia.



Fokus i dedikuar në rritjen e mbledhjes së të ardhurave dhe uljen e varësisë nga grantet e qeverisë qendrore.

#12

NË RENDITJEN E PËRGJITHSHME

#6



NË KATEGORINË
"BASHKIA PËR QYTETARËT"

44%

REZULTAT NË KATEGORINË
"TRANSPARENCA"



1

Bashkia për Qytetarët





2

Bashkia për Bizneset





3

Administrimi Bashkiak



4

Transparenca



13

BASHKIA SARANDË



REZULTATI TOTAL 30/100

Performanca e përgjithshme

Bashkia e Sarandës renditet e fundit në renditjen e përgjithshme me 28 pikë të shënuara në total. Sipas kategorive rezultatet e arritura nga bashkia janë: 43 përqind në Administrimin Bashkiak, 31 përqind në Bashkia për Biznesin, 29 përqind në Bashkia për Qytetarët dhe 0 në Transparencë.

Në Bashkia për Qytetarët, Bashkia e Sarandës renditet e fundit në renditjen sipas kategorive me 30 përqind në fushën e Shërbimeve Komunale, 0 në Edukim dhe 41 përqind në fushën e indikatorëve që lidhen me Mirëqenien Sociale. Në lidhje me furnizimin me ujë, bashkia duhet të përqëndrohet në rritjen e aksesit të qytetarëve në furnizimin me ujë duke përmirësuar performancën e menaxhimit dhe uljen e çmimeve për familjet dhe bizneset. Më shumë vëmendje duhet t'i kushtohet indikatorëve të Edukimit ku bashkia shënoi më ulët se të gjitha bashkitë e tjera me përqendrim më të lartë të nxënësve për klasë.

Në kategorinë Bashkia për Biznesin, Bashkia Sarandë u rendit në vendin e 10 me një rezultat kategorie prej 31 përqind. Me një numër relativisht të lartë të bizneseve për 1000 banorë, bashkia nuk ofron informacion të hapur në lidhje me procedurat për biznesin në varësi të saj. Megjithë një numër më të lartë se mesatarja e lejeve të reja të ndërtimit të lëshuara, bashkia duhet të synojë të zvogëlojë numrin e ditëve për të marrë një leje ndërtimi e cila është krahasimisht më e lartë se pjesa më e madhe e bashkive në analizë.

Në kategorinë e Administrimit Bashkiak, Bashkia Sarandë renditet e 14-ta duke shënuar më lart në fushën e të Ardhurave me 59 përqind performance më e lartë se mesatarja për fushën më specifike në indikatorin që lidhet me mbledhjen e të ardhurave, e reflektuar kjo në mbulimin e shpenzimeve të veta dhe një raport varësie nga grantet më të ulët se mesatarja. Në Shpenzime, bashkia arrin të menaxhojë relativisht në mënyrë më efektive sesa performanca mesatare e bashkive të tjera.

Bashkia e Sarandës renditet e fundit në kategorinë e Transparencës duke performuar më ulët se çdo bashki në Indeks. Me një faqe web funksionale në vetëm pak seksione, bashkia nuk i vë në dispozicion informacion qytetarëve mbi vendimmarrjen e saj dhe nuk i përgjigjet kërkesës për informacion. Bashkia nuk e ka publikuar raportin e performancës buxhetore në platformë.

Indikatorët me performancë të lartë



Performancë më e lartë se mesatarja për indikatorët e të Ardhurave me një performancë të lartë mbledhjeje.



Manaxhim efektiv i shpenzimeve në krahasim me mesataren e Indeksit në këtë fushë indikatorësh.



Një numër i madh biznesesh për 1000 banorë.

Fushat për përmirësim



Bashkia duhet të synojë reduktimin e numrit të ditëve për të marrë një leje ndërtimi.



Më shumë vëmendje ndaj Edukimit për të ulur numrin e nxënësve për klasë.



Platformë informimi pa informacion dhe mospërgjigje ndaj kërkesave për informim nga qytetarët.

#16

INË RENDITJEN E PËRGJITHSHME

#14



NË KATEGORINË "ADMINISTRIMI BASHKIAK"

11%

REZULTAT NË KATEGORINË "TRANSPARENCA"



1

Bashkia për Qytetarët





2

Bashkia për Bizneset





3

Administrimi Bashkiak



4

Transparenca



14

BASHKIA SHKODËR



REZULTATI TOTAL 71/100

Performanca e përgjithshme

Bashkia Shkoder renditet në vendin e 1-të në renditjen e përgjithshme të Indeksit të Performancës së Bashkive me një rezultat të përgjithshëm prej 71 pikë nga 100. Në performancën sipas kategorive bashkia shënoi 100 përqind në Transparencë, 70 përqind në Administrimin Bashkiak, 64 përqind në Bashkia për Qytetarët dhe 52 përqind në Bashkia për Biznesin.

Në kategorinë Bashkia për Qytetarët, Bashkia Shkodër renditet në vendin e parë me një performancë sipas fushave të indikatorëve prej 46 përqind në Shërbime komunale, 85 përqind në Edukim dhe 80 përqind në fushën e Mirëqenies Sociale. Bashkia arrin të sigurojë furnizimin me ujë të rrjedhshëm me çmime të përballeshme për familjet dhe bizneset, ndërsa UKT mbulon veprimtarinë me burimet e veta. Të gjitha zonat administrative janë të mbuluara me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve të ofruar nga një operator privat.

Lidhur me lehtësimin e mjedisit të të bërit biznes, Bashkia Shkodër renditet në vendin e 7-të në kategorinë Bashkia për Biznesin duke shënuar një performance më të lartë se mesatarja për kategorinë. Me një numër biznesesh për 1000 banorë më të lartë se mesatarja e bashkive në fokus, bashkia ofron informacion të plotë në dispozicion të publikut për procedurat e biznesit që lidhen me qeverisjen vendore ndërsa numri i vendimeve kundër në Gjykatën Administrative është në rritje për vitin 2019 në krahasim me 2018.

Bashkia Shkodër renditet e dyta në kategorinë e Administrimit Bashkiak duke manifestuar një menaxhim të kujdesshëm të shpenzimeve publike ndërsa ka investime të ulëta kapitale për frymë për vitin në analizë. Bashkia varet për më shumë se gjysmën e buxhetit vjetor të saj nga grantet dhe ka të ardhura më të ulëta për frymë krahasuar me bashkitë e tjera përfshirë në Indeks.

Kampione në kategorinë e Transparencës, Bashkia Shkoder renditet në vendin e parë me rezultatin 100 përqind. Qeverisje lokale e hapur dhe transparente që përmban një platformë informative të përditësuar me një vëmendje të përkushtuar për t'iu përgjigjur pa vonesë kërkesave për informacion nga qytetarët e interesuar për të marrë pjesë në proceset e hartimit të politikave. Procesi i zbatimit transparent të buxhetit dhe asnjë konstatim i parregullsive në prokurimet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në 3 vitet e fundit.

Indikatorët me performancë të lartë



Furnizim me ujë 24 orë duke ofruar çmime të përballeshme për familjet dhe bizneset, ku UKT mbulon aktivitetin me burimet e veta.



Numër optimal i nxënësve për klasë në terma të krahasueshëm me bashkitë e tjera.



Qeverisje lokale e hapur dhe transparente reflektuar në një platformë informative miqësore në përdorim nga qytetarët. Ofron të gjitha shërbimet për qytetarët duke mbajtur një administratë të vogël në madhësi.

Fushat për përmirësim



Numri i vendimeve kundër bashkisë në Gjykatën Administrative është në rritje vitet e fundit.



Bashkia varet për më shumë se gjysmën e buxhetit vjetor të saj nga grantet dhe ka të ardhura krahasimisht më të ulëta për frymë.



Investime të ulëta kapitale për banor.

#1

NË RENDITJEN E PËRGJITHSHME

#1



NË KATEGORINË "BASHKIA PËR QYTETARËT"

52%

REZULTAT NË KATEGORINË "BASHKIA PËR BIZNESET"



1

Bashkia për Qytetarët





2

Bashkia për Bizneset





3

Administrimi Bashkiak



4

Transparenca



15

BASHKIA VLORË



REZULTATI TOTAL 47/100

Performanca e përgjithshme

Bashkia Vlorë renditet në vendin e 13-të në Indeksin e Performancës së Bashkive me një rezultat të përgjithshëm prej 47 pikësh. Për sa i përket rezultatit sipas kategorive, bashkia ka shënuar 67 përqind në Transparencë, 52 përqind në Bashkia për Qytetarët, 49 përqind në Administrim Bashkiak dhe 8 përqind në Bashkia për Biznesin.

Në kategorinë Bashkia për Qytetarët, me rezultatin 52 përqind Bashkia Vlorë renditet në vendin e 9-të. Në fushën e Shërbimeve komunale rezultati i bashkisë është 31 përqind, 53 përqind në Edukim dhe 83 përqind në Mirëqenien sociale. Bashkia duhet t'i kushtojë vëmendje përmirësimit të kapaciteteve të infrastrukturës për të rritur furnizimin me ujë në zonat administrative që mbulon dhe të synojë përmirësimin e efektivitetit në menaxhimin e UKT. Numri i nxënësve për klasë mund të zvogëlohet për të krijuar kushte më të mira mësimi. Për menaxhimin e mbetjeve, bashkia duhet të synojë zgjerimin e shërbimeve për të përfshirë të gjitha zonat administrative në përgjegjësi.

Bashkia ka performancën e saj më të ulët krahasimisht me bashkitë e tjera në Indeks në kategorinë e Bashkisë për Biznes, duke u renditur e fundit me rezultatin prej vetëm 8 përqind. Me një numër relativisht të lartë të bizneseve për 1000 banorë, mungon informacioni publik për të orientuar bizneset në procedurat që lidhen me pushtetin vendor. Bashkia Vlorë numëron krahasimisht numrin më të madh të vendimeve të Gjykatës Administrative kundër saj ndërsa numri i ditëve për të marrë një leje ndërtimi është më i larti në krahasim me bashkitë e tjera në fokus.

Në kategorinë e Administrimit Bashkiak, bashkia u rendit në vendin e 7 duke shënuar 69 përqind në të Ardhura, 88 përqind në Ahpenzime dhe 68 përqind në fushën e indikatorëve të lidhur me borxhin. Bashkia vazhdon të jetë e varur nga grantet e qeverisë qendrore pavarësisht nga një numër relativisht kumulativ i lartë i bizneseve të regjistruara ndërsa përmirësimet në efektivitetin e mbledhjes së të ardhurave mbeten të rëndësishme.

Për Transparencën, Bashkia Vlorë renditet në vendin e 9-të duke shënuar 67 përqind, me 100 përqind në fushën e Të drejtës së informimit, 67 përqind në Informacionin në internet, por me performancën minimale krahasuese për Transparencën Buxhetore.

Indikatorët me performancë të lartë



Një platformë funksionale dhe e përditësuar e informacionit lehtësisht të aksesueshëm për qytetarët.



Përgjigje ndaj kërkesave qytetare në lidhje me të Drejtën e Informimit



Bashkia arrin të mbulojë gjithë territorin e saj me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve përmes një operatori privat.

Fushat për përmirësim



Vëmendje e shtuar në përmirësimin e kapaciteteve të infrastrukturës për të rritur furnizimin me ujë.



Improve the doing business environment and ease procedures to obtain a building permit by primarily lower the number of days necessary.



Important to improve effectiveness of revenue collection in order to reduce dependency on grants.

#13

NË RENDITJEN E PËRGJITHSHME

#7



NË KATEGORINË
"ADMINISTRIMI BASHKIAK"

8%

REZULTAT NË KATEGORINË
"BASHKIA PËR BIZNESET"



1

Bashkia për Qytetarët





2

Bashkia për Bizneset





3

Administrimi Bashkiak



4

Transparenca



16

BASHKIA VORË



REZULTATI TOTAL 56/100

Performanca e përgjithshme

Bashkia Vorë renditet e 6-a në Indeksin e Performancës së Bashkive me një rezultat të përgjithshëm prej 56 pikë. Në rezultatin sipas kategorive bashkia shënoi 76 përqind në Administrimin Bashkiak, 59 përqind në Bashkia për Biznesin, 56 përqind në Transparencë dhe 36 përqind në Bashkia për Qytetarët.

Në kategorinë Bashkia për Qytetarët, Bashkia e Vorës u rendit e 14-ta, nën rezultatin mesatar për kategorinë me një performancë në fushën e Shërbimeve Komunale 27 përqind, Edukimi 40 përqind dhe Mirëqenia Sociale 48 përqind. Mungesa e furnizimit me ujë vazhdon të përbëjë shqetësim për qytetarët e Vorës ndërsa çmimet e aplikuara nga UKT janë relativisht të larta në krahasim me bashkitë e tjera në Indeks. Një skemë mjaft e efektshme e mbrojtjes sociale e menaxhuar nga bashkia. Indikatorët e lidhur me Edukimin kërkojnë më shumë vëmendje nga bashkia për përmirësim të mëtejshme në krijimin e kushteve optimale të studimit për nxënësit.

Në kategorinë Bashkia për Biznesin, Bashkia e Vorës u rendit e 3-a me 59 përqind (59.04%) me rezultatin e fushës së Shërbimeve të Biznesit prej 65 përqind dhe Lejet e Ndërtimit 50 përqind. Bashkia ofron një informacion të plotë mbi procedurat për bizneset, megjithatë shihet një rritje e çështjeve të Gjykatës Administrative kundër bashkisë në vitin e kaluar. Megjithatë një performancë të ulët për sa i përket ditëve të nevojshme për të marrë një leje ndërtimi, Bashkia Vore ka numrin më të madh të lejeve të reja të ndërtimit për banor krahasuar me bashkitë e tjera.

Rezultatet e Administrimit Bashkiak e rendisin Bashkinë e Vorës të parën në kategori duke shënuar 76 përqind si performancën më të mirë e me rezultat sipas fushave përkatëse 69 përqind në Shpenzime, 88 përqind në të Ardhura dhe 69 përqind në financimin nëpërmjet borxhit. Bashkia ka performancën më të lartë në mbledhjen e të ardhurave dhe financimin e veprimtarisë me burimet e veta me një varësi minimale nga grantet e qeverisë qendrore. Pa asnjë borxh të jashtëm, Kontrolli i Lartë i Shtetit gjeti parregullsi të vogla në auditimet e raportuara gjatë tre viteve të fundit të marra në analizë për Indeksin.

Për Transparencën, Bashkia e Vorës renditet në vendin e 8-të, më ulët se performanca mesatare e bashkive në fokus. Fushat për përmirësim janë përditësimi i informacionit në faqen web për të qenë i aksesueshëm për qytetarët me interes të marrin pjesë në çështjet e qeverisjes vendore. Bashkia nuk i është kërkesës së drejtuar në kuadër të Ligjit për të Drejtën e Informimit.

Indikatorët me performancë të lartë



Një skemë mjaft efektive e mbrojtjes sociale e menaxhuar nga bashkia.



Informacion i plotë për procedurat e biznesit dhe numri më i lartë i lejeve të reja të ndërtimit për banor.



Performanca më e lartë në mbledhjen e të ardhurave dhe financimi e veprimtarisë së bashkisë me burimet e veta.

Fushat për përmirësim



Mungesa e furnizimit me ujë për qytetarët ndërsa çmimet e aplikuara nga UKT janë relativisht të larta.



Bashkia duhet të marrë parasysh me përparësi të drejtën e qytetarëve për informacion dhe të përgjigjet ndaj kërkesave të tyre.



Numri në rritje i çështjeve të Gjykatës Administrative tregon për më shumë vëmendje nga bashkia në shërbim të komunitetit të biznesit.

#6

NË RENDITJEN E PËRGJITHSHME

#1



NË KATEGORINË
"ADMINISTRIMI BASHKIAK"

36%

REZULTAT NË KATEGORINË
"BASHKIA PËR QYTETARËT"



1

Bashkia për Qytetarët





2

Bashkia për Bizneset




3

Administrimi Bashkiak



4

Transparenca



**GJETJE DHE
REKOMANDIME
PERMIRESUESE**

GJETJE DHE REKOMANDIME PERMIRESUESE

Analiza e paraqitur e rezultateve të Indeksit të Performancës së Bashkive bazohet në të dhënat zyrtare më të fundit të disponueshme për publikun dhe në punën tonë ekipore në mbledhjen e informacionit në lidhje me vlerësimin e efektivitetit të administratës në njësitë e qeverisjes vendore që janë bërë pjesë e Indeksit.

Indikatorët mbi performancën e mirëqeverisjes janë organizuar në katër kategori: (i) Bashkia për Qytetarët, me indikatorë që adresojnë efikasitetin e bashkive në ofrimin e shërbimeve për qytetarët në fushat e Shërbimeve, Edukimit dhe Mirëqenies Sociale; (ii) Bashkia për Biznesin që vlerëson përkushtimin e njësitve të pushtetit vendor në shërbim të sipërmarrjes në fushat e shërbimeve për të lehtësuar të bërit biznes dhe pajisjen me leje ndërtimit, një grup indikatorësh në të cilin Shqipëria ka shënuar rezultate të ulëta në raportet e Bankës Botërore mbi Lehtësinë e të bërit biznes; (iii) Administrimi Bashkiak ku vlerësohet efikasiteti në administrimin e shpenzimeve dhe mbledhjen e të ardhurave nga ana e bashkive dhe realizimi i investimeve publike të planifikuara, dhe (iv) dimensionin e Transparencës ku analizohen indikatorë që lidhen me funksionimin e platformave të Informimit qytetar online në drejtim të ofrimit të informacionit hapur për qytetarët me fokus performancën e qeverisjes vendore, përgjigjen në kuadër të së Drejtës për Informimin, që me ligj është një kërkesë që duhet të zbatohet nga çdo bashki dhe Transparenca buxhetore, duke vlerësuar transparencën e bashkisë në raportimin publik në kuadër të zbatimit të buxhetit.

Rezultatet e përgjithshme tregojnë për disa fusha indikatorësh kryesorë që kanë nevojë për përmirësime lidhur me performancën e bashkive:

- Furnizimi i kufizuar me ujë i qytetarëve mbetet shqetësimi kryesor për disa prej bashkive në fokus, duke pasur parasysh kufizimet në orarin e furnizimit me ujë për qytetarët dhe bizneset. Vazhdimi i përmirësimeve thelbësore në infrastrukturën e furnizimit me ujë është i rëndësishëm për të rritur furnizimin e qendrueshëm dhe aplikimin e çmimeve më të përballueshme për familjet dhe ndërmarrjet që mbështeten tek furnizimi me ujë për të kryer shumicën e aktiviteteve të tyre të përditshme. Efikasiteti më i lartë në menaxhimin e UKT duket se është një çështje me rëndësi që bashkitë duhet t'i kushtojnë një vëmendje të rritur duke patur parasysh edhe natyrën e këtyre kompanive.

- Edukimi është një fushë që nuk lidhet drejtpërdrejt me performancën e njësitve të pushtetit vendor, por në perspektivën e rolit përcaktues të tyre në përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe parashkollore mbetet tejet e rëndësishme që bashkitë të tregohen proaktive në krijimin e kushteve optimale të edukimit duke rritur madhësinë e klasës për të optimizuar numrin relativ të studentëve pjesëmarrës.

- Aksesi i bizneseve në informacion duket se nuk është ende në qendër të fokusit të punës së bashkive dhe duket se është e vështirë për sipërmarrësit të marrin informacion të plotë për procedurat e lidhura me qeverisjen vendore përmes faqeve të internetit përkatëse të disa prej bashkive ndërsa shërbimet e dedikuara të biznesit prej tyre ende

mungojnë. Bashkitë duhet të luajnë një rol proaktiv në krijimin e një mjedisi mundësues për të nxitur e fuqizuar startup-et dhe SME-të. Lehtësia e procedurave dhe zvogëlimi i numrit të ditëve të nevojshme për t'u pajisur me një leje ndërtimi mbetet çështje thelbësore për t'u adresuar nga disa prej bashkive në Indeks.

- Rritja e efektivitetit të administratës vendore është çështje me rëndësi parësore kur bëhet fjalë për menaxhimin financiar të bashkive dhe duhet të marrë vëmendjen e nevojshme nga drejtuesit vendorë të zgjedhur. Shumica e bashkive në fokus vazhdojnë të mbeten shumë të varura nga grantet e qeverisë qendrore ndërsa mund të përmirësojnë ndjeshëm performancën në mbledhjen e të ardhurave dhe financimin e prioriteteve buxhetore me fondet e tyre. Madhësia e administratës së bashkive është një dimension tjetër i rëndësishëm i eficiencës në shpërndarjen e burimeve duke theksuar këtu që duke nisur nga kufizimet buxhetore disa nga bashkitë duhet të arrijnë të përbushin të gjitha funksionet themelore në shërbim të qytetarëve me një ekip kompakt të stafit profesional. Indikatorët e lidhur me performancën mund të përfshihen në vlerësimin vjetor të punës së tyre duke përcaktuar një standard të pranuar për përmirësimin të vazhdueshëm të qeverive lokale. Indeksi i Performancës së Bashkive është një përpjekje për të kontribuar në këtë drejtim.

- Efkasitet më i lartë në menaxhimin e skemave të mbrojtjes sociale. Bashkitë duhet të rrisin efikasitetin në menaxhimin e skemave të mbrojtjes sociale duke krijuar paralelisht më shumë mundësi për krijimin e vendeve të punës, nxitjen e sipërmarrjes dhe mbështetjen e grupeve të marginal-

izuara. Bashkëpunimi më i ngushtë me agjensitë shtetërore të lidhura do të krijonte sinergji dhe më shumë vlerë në rialokimin e burimeve në funksion të rritjes së produktivitetit dhe gjenerimit të aktiviteteve ekonomik nga familjet.

- Transparenca ndaj qytetarëve është një kategori në qendër të vëmendjes së disa bashkive por evidentohen mjaft hapësira për përmirësim në disa të tjera. Zhvillimi i platformave web me informacion të dobishëm për komunitetin duhet të mbetet prioritet, në mënyrë që t'i krijohet mundësia qytetarëve të ndjekin punën e bashkive në realizimin e buxheteve dhe të bëhen pjesë aktive e përgatitjes së planeve strategjike dhe vendimmarrjes në këtë drejtim. Monitorimi dhe marrja e opinionit publik në ciklin e plotë buxhetor nga planifikimi deri në zbatimin e prioriteteve të investimeve publike duhet të jetë pjesë e agjendës së bashkive për transparencë. Disa nga bashkitë duhet të përmirësojnë përgjigjen e tyre ndaj kërkesave të qytetarëve për informacion bazuar në Ligjin për të Drejtën e Informimit dhe të bëjnë publik informacionin e nevojshëm të koordinatorit të përcaktuar dhe mënyrën e kontaktimit për të marrë përgjigje brenda afateve ligjore.

Kjo kërkon të krijohet një bazë e qëndrueshme informacioni gjithëpërfshirës e transparent mundësisht për të gjithë bashkitë. Ky informacion dhe analizat profesionale për efekte e tyre në jetën e përditshme të qytetarëve do të inspironte dhe nxiste një angazhim proaktiv të tyre në çdo fazë të hartimit dhe miratimit të strategjive të zhvillimit dhe të buxheteve afatmesme dhe vjetore të bashkive të tyre. Ndërtimi i serive kohore afatgjata të indikatorëve të mireqeverisjes vendore

do të krijonte premisa positive për përmirësimin e vazhdueshme të performancës së bashkive, shërbimeve të qeverisjes vendore dhe premtimeve elektorale të kryetarëve të bashkive dhe keshillave vendore.

Edicioni i parë i Indeksit të Performancës së Bashkive është një përpjekje e përkushtuar e ekipit të IPPM për të ndërtuar një platformë krahasuese me epiqendër në vlerësimin e performancës së bashkive në shërbim të qytetarëve, bizneseve dhe interesit publik përmes krijimit të vlerës për komunitetet dhe palët e interesuara. Sinergjia me qeverinë qendrore paralelisht me decentralizimin e mëtejshëm të kompetencave edhe financiare mbeten dimensione thelbësore për të ndërtuar një qeverisje lokale efektive dhe të qëndrueshme, e nxitur dhe orientuar nga nevojat e qytetarëve bazuar në bashkërendimin e nevojshëm për t'i adresuar ato me efikasitet më të lartë.

Disponueshmëria e të dhënave për pushtetin vendor në Shqipëri përtej progresit të bërë mbetet një sfidë që duhet adresuar me qëllim

përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së përgjithshme të qeverisjes lokale në vend dhe krijimin e kushteve që studiuesit dhe akademikët të kontribuojnë përmes punës së tyre analitike në mprehjen e mëtejshme të debatit tematik në këtë fushë. Kjo iniciativë synon të krijojë një pikë referimi në standardet e mirëqeverisjes vendore dhe të krijojë themelet për zhvillimin e një baze të të dhënave të qeverisjes lokale me të dhëna të lidhura me performancën qeverisëse, duke kontribuar në ngushtimin e hendekut ekzistues në statistikat zyrtare në nivel bashkie.

Instituti për Politika Publike dhe Mirëqeverisje synon të zgjerojë analizën në të gjitha 61 bashkitë e Shqipërisë me qëllim adresimin e një domosdoshmërie të ngutshme të matjes së performancës së qeverisjes vendore, rritjen e përgjegjshmërisë së zyrtarëve të zgjedhur vendorë dhe advokimin proaktiv për t'i bërë qytetarët pjesë aktive të procesit të politikëbërjes, planifikimit e vendimmarrjes vendore.

PYETJET E BËRA MË SHPESH

Pse bashkitë e mëdha si Tirana apo Durrësi nuk janë përfshirë në "kampion"?

Tirana dhe Durrësi dhe dy bashkitë më të mëdha në vend dhe përsa i përket buxhetit në dispozicion dhe përqendrimit të popullsisë ato do të sillleshin si "të jashtëm" në kampion duke e bërë të vështirë ndërtimin e krahasimeve mbi ndryshimet në performancën e bashkive përkatëse.

Pse indikatorët sasiorë të indeksit nuk ndikohen drejtpërdrejt nga bashkitë?

Ekzistojnë dy lloje të indikatorëve të indeksit - ata që pasqyrojnë bashkitë në mënyrë të drejtpërdrejtë (si taksa mbi pronën) dhe ato që pasqyrojnë ndikimin indirekt, d.m.th tregon efektivitetin e vendimeve bashkiake. Për shembull, vlerësimi i numrit të nxënësve për klasë pasi shkollat ndërtohen nga bashkitë.

Pse indeksi nuk merr parasysh funksionet e tjera që pjesërisht janë pjesë e portofolit të bashkive, të tilla si aktivitete kulturore, sportive apo aktivitete të tjera?

Indeksi nuk synon të mbulojë të gjitha aktivitetet e bashkive por vetëm fushat që lidhen më ngushtë me jetën ekonomike të qytetarëve. As nuk ka për qëllim të përcaktojë në cilën bashki është vendi më i mirë për të jetuar, ose ku njerëzit janë më të lumtur - vlerësojnë me qëllim faktorët ekonomikë dhe vendimet që kanë ndikim nga bashkitë.

Pse indeksi bashkiak ul vlerësimin e bashkive ku ndërmarrjet publike zotërojnë veprimtari tregtare?

Një vlerësim më i mirë është marrë nga bashkitë ku transporti, shërbimet publike etj. sigurojnë pjesëmarrjen e biznesit. Përfshirja e sektorit privat lejon çmime më të ulëta dhe cilësi më të lartë në ofrimin e shërbimeve. Sipas rrugës së zhvillimit

ekonomik të zgjedhur nga Shqipëria, aktivitetet duhet të kryhen nga sipërmarrës dhe ndërmarrje, jo nga Shteti ose bashkitë. Nuk ka arsye pse bashkitë ende zotërojnë menaxhim e mbetjeve, shërbime funerale, etj.

Pavarësisht kësaj vlere, nëse disa ndërmarrje bashkiake të cilat ofrojnë shërbime veprojnë me humbje, ose u ofrojnë shërbime konsumatorëve nën çmim, kjo reflektohet pozitivisht në indikatorë të tjerë.

Pse bashkitë që kryejnë procedurat e prokurimit publik në mënyrë të hapur (prokurim publik) vlerësohen më mirë, megjithëse në disa prokurime janë procedura të tjera që mund të përdoren?

Megjithëse legjislacioni nuk kërkon botimin e prokurimeve publike në çdo kohë, botimi i tyre siguron që të gjithë pjesëmarrësit e interesuar të tregut të kenë mundësinë të vendosin nëse do të marrin pjesë në procedurë. Administrata bashkiake nuk përdor paratë e veta, por paratë e taksapaguesve. Standardet e mireqeverisjes tregojnë se tenderët e hapur dhe procedurat buxhetore transparente çojnë në çmime më të ulëta dhe kursim të parave të taksapaguesve.

Gjatë hartimit të indeksit, një pjesë e informacionit është mbledhur nga bashkitë për të siguruar që bashkitë të mund të korrigjojnë informacionin?

Të gjitha të dhënat e mbledhura janë kontrolluar me kujdes e në rast dyshimesh për korrektësinë e të dhënave u janë dërguar pyetje të dedikuara bashkive dhe janë marrë përgjigjet përkatëse prej tyre, duke ju referuar kushteve të përcaktuara në Ligjin për të Drejtën e Informimit dhe ligje të tjera në Republikën e Shqipërisë mbi informacionin publik.

